ISSN 1857-6443

Përkujtohet 20 vjetori i eksodit masiv të shqiptarëve të Kosovës

Fq.5

RASTI SAZDOVSKI

Të përjashtohet prokurori Fidovski

Fq.6

Koncepti Shoqëri vs Republikë

Dr.Arben Taravari

www.koha.mk

Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XIII · Numri 3628 · e shtunë-e diel, 6-7 prill 2019 · 4°c | 17°c · 15 DEN



KOHA në mozaik

Fq.13-15

FORUM

Gara për të "shtrënguar daullen", pa "tradhti"

Disa qarqe ose individë të cilën në zemër e kanë shqiptarinë, e kanë kuptuar shumë seriozisht garën presidenciale. Siç i ka hije kauzës kombëtare, japin apele e bëjnë gjyqe publike se po u votua kandidati maqedonas (mendohet në njërin nga dy sish), do të jetë tradhti. Dhe "tradhtia" u adresohet partive shqiptare që e kanë mbështetur kandidatin e koalicionit. Sikundër që, me të njëjtën logjikë, patriotizmi kësaj radhe shprehet duke apeluar që të votohet kandidati shqiptar, i përkrahur nga dy...

Fq.11

RAJON

Incident në mes Kosovës dhe Serbisë në Tiranë

Fq.16

GLOBI

Kërcënimi rus, NATO me flotë në Detin e Zi

Fq.17

OFERTAT E KANDIDATËVE PRESIDENCIALË

NACIONALJA APO QYTETARJA DO TË TRIUMFOJË?

Poziviteti i këtyre zgjedhjeve presidenciale është se për herë të parë kemi dy koncepte te kundërta, thonë analistët. Koncepti i parë është se po tenton t'i çojë në harresë elementet nacionaliste dhe armiqësore, ndërsa koncepti i dytë - që edhe më tepër e nxitë nacionalizmin tek maqedonasit dhe shqiptarët

Fq.4

Mijëra migrantë prapa dyerve të Maqedonisë

Shkup, 5 prill - Migrantët ilegal edhe më tej paraqes sfidë për Maqedoninë e Veriut dhe Ballkanin Perëndimor. Autoritetet nuk përjashtojnë mundësinë për lëvizje të reja. Në anën tjetër të kufirit me Greqinë, nga dita e enjte janë stacionuar rreth 1500 migrantë, ndërsa 500 janë afruar deri në Selanik. "Një nga sfidat që është tani dhe që do të ekzistojë edhe më tej sigurisht se është migrimi. Rruga përmes Maqedonisë në Serbi dhe në vendet tjera për një kohë të gjatë nuk përdorët nga migrantët. Tani ata lëvizin përmes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnje Hercegovinës, ose nga Shqipëria në Italì dhe më tej drejt vendeve të Evropës. Ne bashkëpunojmë në këtë pjesë me shtetet e rajonit dhe Bashkimin Evropian (BE), politikat e së cilës i ndjekim edhe me ballafaqimin me krizat e migrantëve. Jemi të gatshëm...

Fq.8

EDITORIAL

ÇFARË DO TË THOTË HUMBJA E STAMBOLLIT DHE ANKARASË PËR ERDOGANIN

The Economist

Politikisht, rezultati e vendos Erdoganin në pozitë të vështirë, pasi do të ndodhet midis votës së kurdëve, të cilët votuan për opozitën, dhe votës së nacionalistëve. Çdo përpjekje për të ndërmarrë bisedime paqeje me PKK-në (Partinë e Punëtorëve të Kurdistanit, një grup i armatosur separatist, i shpallur i paligjshëm), mund të sjellë ndërprerjen e aleancës me nacionalistët

Në vitet e shkuara, presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan dhe qeveria e tij kanë marrë kontrollin e gjyqësorit dhe kanë penguar shtypin, duke bërë që demokracia turke të mbetet vetëm te kutia e votimit. Dhe kutia e votimit goditi në zgjedhjet vendore të 31 marsit. Edhe pse fitoi shumicën në shkallë kombi, partia e Erdoganit pësoi humbje të ndjeshme në pesë nga gjashtë qytetet e mëdha, përfshirë Stambollin, lokomotivën ekonomike, dhe kryeqytetin, Ankaranë.

Humbjen e Stambollit do ta ketë ndier më shumë, pasi Erdogani e nisi aty karrierën e tij politike, më shumë se 20 vite më parë. Kandidati i partisë së tij për kryetar bashkie, një ish kryeministër dhe ish kryetar parlamenti, Binali Jildirim, pati mbështetjen e mediave më të fuqishme, që janë pro-qeveritare; pati mbështetjen e pandalshme të makinerisë zgjedhore të partisë së tij; si dhe mbështetjen e presidentit Erdogan, i cili e mbrojti me aq shumë forcë sa dukej sikur po luhej karriera e tij. Kandidati i opozitës, Ekrem Imamoglu, pati mbështetjen e një partie të paqëndrueshme të opozitës, vetëm pak nga burimet e kundërshtarit për fushatë, dhe vetëm pak vite përvojë si kryetar bashkie. Por ky kandidat pothuajse i panjohur ka shkaktuar një nga përmbysjet më të mëdha në historinë zgjedhore të Turqisë, dhe ka fituar me pak vota diferencë.

Rastet e dhunës dhe debatet kanë hedhur hije dyshimi mbi votën. Menjëherë pasi u njoftua që kandidati i opozitës ishte përpara me vota, agjencia shtetërore e lajmeve ndaloi së raportuari rezultatet e garës, duke i qëndruar besnike qeverisë. Më pas, të dy kandidatët shpallën fitore. Ditën e nesërme, kur rezultatet treguan se Imamoglu ishte rreth 30 mijë vota përpara dhe mbeteshin gati 10 kuti pa numëruar, në disa qendra votimi pati përplasje fizike. Ndërsa në zona të tjera të vendit, dhuna mori përmasa vdekjeprurëse. Dy veta u vranë në Malatja, dy në Gaziantep, në jug të vendit. Pjesëmarrja në votime ishte 85%.

Erdogani arriti të shpallë fitoren, meqenëse partia e tij, me ndihmën e aleatëve nacionalistë, fitoi në shumicën e 81 provincave, duke mbledhur 52% të votës popullore. Partia kryesore e opozitës, e drejtuar nga Partia Popullore Republikane, mori 38%. Erdogani deklaroi se partia e tij kishte dalë si forca e parë politike në vend, por pranoi që kishin pasur rënie të votuesve në qytetet e mëdha. Ai premtoi të marrë masa për të ndrequr ekonominë, e cila ka nisur recesionin, dhe se do t'i bindet rregullave të tregut të lirë. Por tregjet e lira nuk fituan siguri nga kjo. Lira turke humbi 2% të vlerës ndaj dollarit këtë të hënë, duke shënuar javën më të keqe që nga kriza e verës që shkoi. Bizneseve nuk u është larguar ende frika se mund të sakrifikohet rendi ekonomik për hir të përfitimeve politike. Por humbja e këtyre zgjedhjeve nuk është aspak goditje e rëndë për Erdoganin dhe partinë e tij. Presidenti turk vazhdon të ketë një kushtetutë që i jep fuqi të mëdha. Partia e tij, Drejtësi dhe Zhvillim, vazhdon të ketë shumicën në parlament, me ndihmën e nacionalistëve. Megjithatë, humbjet në qytetet e mëdha e kanë lënduar nga pikëpamja simbolike dhe ajo praktike. Bashkitë luajnë rol kyç në rrjetet e klientelës. Po ashtu, kryebashkiakët opozitarë mund të zbulojnë skandale.

Politikisht, rezultati e vendos Erdoganin në pozitë të vështirë, pasi do të ndodhet midis votës së kurdëve, të cilët votuan për opozitën, dhe votës së nacionalistëve. Çdo përpjekje për të ndërmarrë bisedime paqeje me PKK-në (Partinë e Punëtorëve të Kurdistanit, një grup i armatosur separatist, i shpallur i paligjshëm), mund të sjellë ndërprerjen e aleancës me nacionalistët. Një akademik te Universiteti Bilgi, Emre Erdogan (nuk ka lidhje me presidentin, pavarësisht mbiemrit), thotë që partitë nacionaliste kanë fuqinë për ta shpërndarë parlamentin dhe ta çojnë vendin drejt zgjedhjeve të parakohshme, kurdo që ta shohin të arsyeshme. Kjo e bën shumë të vështirë bashkëpunimin me kurdët. Për sa i përket stabilitetit të vendit, shqetësimi më i madh është nëse Erdogani do ta mbajë fjalën e të përzërë disa nga kundërshtarët e tij, që nga Mansur Javas, që fitoi garën në Ankara, dhe kryetarët e bashkive të Partisë Popullore Demokratike, e cila fitoi më shumë në zonën kurde, në jug-lindje. Para zgjedhjeve, ministri i brendshëm i Erdoganit pati deklaruar se 231 kandidatë të opozitës po hetoheshin për terrorizëm.

Prokurorët nisën një hetim ndaj Javasit, në bazë të deklaratave të vjetra që e lidhnin me një çek të falsifikuar. Këto kërcënime nuk merren lehtë në Turqi, pasi në zgjedhjet e mëparshme vendore, në jug-lindje u votuan 102 kryebashkiakë nga Partia Popullore Demokratike. Por 94 prej tyre u shkarkuan dhe u arrestuan, me akuza bashkëpunimi me PKK, dhe u zëvendësuan nga njerëz të besuar të qeverisë.

KUR S'TA RROKË E MASANDEJ TA RROKË!

"Kur isha në Kosovë, disa njerëz që i njoh i pyeta se a ishin veteranë të UÇK-së. Të paktën dy prej tyre m'u përgjigjen kështu: 'Ma prunën kërkesën dhe e nënshkrova!'

I kuptoja se ndiheshin keq duke ditur se do t'i kem mbajtur në mend nga lufta se nuk kanë qenë ushtarë të UÇK-së. Por e kisha vështirë të besoja se dikush do t'ua ketë ofruar ashtu kot kërkesën e plotësuar në emër të tyre!!! Si vështirë të gjendeshin vullnetarë të tillë kur dihet se njerëzit kanë shitur statuset e veteranëve me nga 2500 e më shumë euro!

Por, një gjë nuk e kam të qartë. Si iu përgjigjen këta njerëz fëmijëve të tyre kur i pyesin për luftën, sidomos ata që i kanë fëmijët e rritur dhe që e dinë mirë se etërit e tyre nuk kanë qenë ushtarë të UÇK-së. Si iu përgjigjen grave, të tyre? Pse ata të jenë veteranë të UÇK-së dhe ato të mos jenë, kur tërë kohën kanë qenë së bashku?! A nuk është ky një diskriminim klasik që iu vjen grave në të njëjtën kohë jo vetëm nga shoqëria, por edhe nga burrat e tyre? Si mund të jetë veteran një mashkull vetëm pse me profesion është mjek dhe aty ku ka jetuar ka kryer punën e vet?! E pse atëherë nuk janë shpallur të gjithë mjekët veteranë, por dikush po e dikush jo? Pse, në bazë të të njëjtit princip, nuk janë shpallur veterane edhe të gjitha infermieret. Nuk ka asnjë mjek që ka marrë frymë në Kosovë dhe që nuk ka ndihmuar pacientët. Mjeku nuk bën punë tjetër pos t'i mjekojë të sëmurët. A duhet që vetëm pse është mjek të jetë veteran? Apo, pse të jetë veteran lufte një tregtar që ka furnizuar popullin dhe ushtrinë, por njëkohësisht ka nxjerr përfitimet e veta?! Apo, një këngëtar që kurrë nuk është dukur në fronte lufte, por që ka bërë këngë patriotike pas lufte, për të cilat është paguar?! Por, ka edhe më zi. Ja një rast i tillë, "më i zi".

Unë: A je veteran?
Ai: Po.
Unë: Më duket se nuk ishe ushtar në luftë.
Ai: Aiii doktor, i vonë je ti. Stërgjyshi im ka qenë luftëtar i Azem Bejtës.
Unë: Stërgjyshi po, por ti jo.
Ai: Pastaj, gjyshi im ka qenë luftëtar i Shaban Polluzhës.
Unë: Gjyshi po, por ti jo.
Ai: Edhe unë kam qenë, doktor. Gjatë luftës tërë kohën kam ndejtë në Drenicë, kurrë nuk jam larguar.
Unë: Në Drenicë ke ndejtë, por ushtar nuk ke qenë.
Ai: E djali i axhës tim?!
Unë: Çka, djali i axhës tënd?
Ai: Djali i axhës tim ka ndejtë krejt kohën në Ulqin dhe tash është veteran. Pse unë që kam qenë krejt kohën në Kosovë të mos jem veteran e ai po?!
Unë: Po, po. Dikush krejt kohën ka qenë në Gjermani, në Zvicër, Suedi... e tash është veteran. Pse të mos jesh edhe ti!?
Ai: E sheh doktor. Më në fund ta rroku.
Unë: Më fal që të mundova se nganjëherë vërtet nuk ma rrokë!
Ai: Jo, jo, s'ka problem doktor!", shkruan në FB, shkrimtari Liri Loshi.

MEDIACitate

Piloti i avionit etiopian nuk ka gabuar

Katër javë pas rrëzimit të avionit Boeing 737 Max të shoqërisë Ethiopian Airlines u publikua raporti i parë hetimor. Pilotët i kanë respektuar të gjitha rregullat, aksidentin dyshohet se solli një gabim i software-it.

Ekuipazhi i avionit Boeing 737 Max të rrëzuar në Etiopi, i ka respektuar të gjitha rregulloret e parashkruara, por nuk mund të vendoste dot nën kontroll avionin. Këtë e konfirmon raporti i parë i ndërmjetëm hetimor mbi tragjedinë e avionit të rrëzuar më 10 Mars, bëri të ditur ministrja e Transportit në Addis Abeba, Dagmawit Moge.

Në tragjedinë e rrëzimit të avionit të shoqërisë etiopiane të fluturimit humbën jetën 157 vetë. Hetuesit kanë gjetur të dhëna se pjesa ballore e avionit ka pasur një shtypje, tha Dagmawit. Prodhuesi i avionëve duhet të kontrollojë sistemin e kontrollit të avionit. Rrëzimi i avionit e vendosi nën presion të madh prodhuesin amerikan të avionëve, Boeing dhe Autoritetin Amerikan të Aviacionit, FAA. Në fokus të kritikave ndodhet një software, i cili pas rrëzimit të të njëjtit tip avioni Boeing në Indonezi, ku humbën jetën 189 vetë, shihet si shkaku i tragjedisë. Boeing premtoi pas tragjedisë, se do të kryejë një ripunim të programit, por update-imi i tij ende nuk është kryer.

Deri në sqarimin e plotë të arsyes së aksidentit ajror janë vendosur në të gjithë botën ndalimfluturime për avionët e tipit 737 Max - avioni më i suksesshëm i shitur i Boeing. 370 avionët që kanë qenë në qarkullim tani qëndrojnë në pistë, ndërkohë që shumë porosi për avionin janë pezulluar.

KRYEMINISTRI I BINDUR SE PO ECIM DREJT

ZAEVI BESON NË MARRJEN E DATËS PËR NEGOCIATA

Në pyetjen e gazetarëve nëse do të mbajë përgjegjësi nëse nuk ka datë në qershor, kryeministri u përgjigj se nuk do të mbajë përgjegjësi, sepse vendi do të marrë datë për negociata

Koha — Zejnulla VESELI

Shkup, 5 prill - Besoj se këtë vit vendi ynë do të marrë datë konkrete për negociata dhe nuk kam dilemë rreth asaj, veçanërisht duke e ditur se mbeti vetëm edhe një ligj që duhet ta dakordojmë nëpër dialog politik, deklaroi kryeministri Zoran Zaev pas takimit me Odat ekonomike për nismën e vendosjes së orarit të shkurtuar të punës gjatë shfrytëzimit të mungesës prindërore.Në pyetjen e gazetarëve nëse do të mbajë përgjegjësi nëse nuk ka datë në qershor, kryeministri u përgjigj se nuk do të mbajë përgjegjësi, sepse vendi do të marrë datë për negociata. "Absolutisht jo, për shkak të asaj që së pari do të kemi datë, pyetjet që për momentin shqyrtohen, hapësira e ngushtë mes zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, pas të cilave shpallet raporti i Komisionit Evropian edhe katër ditë disa parlamente kanë mundësi ta miratojnë atë raport që t'u japin "pas" vendeve anëtare të Këshillit të BE-së ta sjellin vendimin", tha Zaev. aI Potencoi se Ligji për prokurorinë publike është përgatitur në mënyrë transparente dhe se shumicë e madhe qëndron pas tij.

"Shumicë e madhe qëndron pas Ligjit. Duhet për fat të keq të sigurohet shumicë prej dy të tretave, nëse e sigurojmë ne nuk kemi kusht tjetër që është nga pjesa e kritereve që na janë dhënë për marrje të datës. Do të thotë të gjtiha kushtet tjera që na ishin dhënë gjatë datës së projektuar për fillim të negociatave janë plotësuar, mbeti vetëm pjesa politike, në dakordim për miratim të ligjit për Prokurorinë Publike", sqaroi Zaev, ndërsa shtoi se edhe disa ligje duhet të miratohen në Parlament, ndërsa ato janë Ligji për këshillin e prokurorëve publik, dhe ligjet për shërbimet e sigurisë, për të cilat është arritur dialog politik mes të gjithë faktorëve politik.

"Kur janë plotësuar të gjitha reformat, kur shkëlqejmë në botë, kur mbajmë leksion të Evropës, me sjellje evropiane dhe me vlera e mënyra evropiane të sjelljes, absolutisht as nuk mendoj për dorëheqje", u përgjigj Zaev. Në pyetjen kur do të vazhdojnë negociatat për PSP-në dhe nëse ka afat deri kur do të pritet përkrahje e VMRO-DPMNE-së opozitare, Zaev thotë se bisedat rrjedhin dhe ka përparim të vogël.

"Do ta lë për atë të komentojnë ministrja e Drejtësisë dhe përfaqësuesit e VMRO-DPMNE-së të cilët për momentin bisedojnë. Partitë më të vogla opozitare siç është Aleanca për Shqiptarët dhe Besa i dhanë instruksionet e tyre dhe dhanë hapësirë të arrihet marrëveshje së pari me partinë më të madhe opozitare. Tetë deputetët të cilët janë në grupin e ri të deputetëve të VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit gjithashtu dhanë instruksione dhe drejtime të tyre por dhanë hapësirë së pari me partinë më të madhe opozitare. Besoj se në kohën më të shpejtë ajo do të japë fryt, dhe besoj se do të gjinden mënyra ajo të sillet në kohë, që të përbëhet një pjesë e raportit, që publikohet pas përfundimit të zgjedhjeve për PE-në, por shkruhet në fillim të muajit maj", tha Zaev. Kryeministri vlerëson se koha është shumë e shkurtër, por shpreson se do të arrihet konsensus për këtë çështje, që të mund të sjellim vendim në Parlamentin tonë, duke shprehur bindje se marrëveshja për ligjin e prokurorisë publike do të arrihet para zgjedhjeve presidenciale.

Publicitet

OFERTAT E KANDIDATËVE PRESIDENCIALË

NACIONALJA APO QYTETARJA DO TË TRIUMFOJË?

Poziviteti i këtyre zgjedhjeve presidenciale është se për herë të parë kemi dy koncepte te kundërta, thonë analistët. Koncepti i parë është se po tenton t'i çojë në harresë elementet nacionaliste dhe armiqësore, ndërsa koncepti i dytë - që edhe më tepër e nxitë nacionalizmin tek maqedonasit dhe shqiptarët

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 4 prill - Edhe në ditën e pestë të garës presidenciale, kandidatët vazhdojnë me retorikën e dy ofertave, varësisht nga përkatësia etnike e votuesve. Sipas analistëve dhe ekspertëve universitar, pikërisht kjo mënyrë e pasimit të ofertave ka për qëllim të testoj se si do të pozicionohen qytetarët apo votuesit në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

Profesoresha universitare Mirjana Malevska, vlerëson se në lojë dy opsione, ose me fjalë të tjera, testimi i diskursit etnik dhe konceptit të votuesve qytetarë.

"Pretimet dhe ofertat e kandidatëve për president shteti, të paktën në rrethin e parë, do të jenë të ndarë. Kjo është njëra situatë e votimit në bazë të etnikumeve. Koncepti i dytë është ai qytetar që bazohet në vizionin qytetar midis diçkaje që paraqet ardhmërinë, nëse do ta definonim konceptin për në NATO dhe BE për të gjithë shoqërinë, dhe konceptin tjetër që e ofron kundërkandidatja që votuesve ju ofron revizion të gjithçkaje që ka bërë deri më tani qeveria aktuale. Dhe kjo shumë do të kontribuojë në ndarjen e trupit votues se janë për ideologji që bazohet në konceptin e etnive, apo ideologjinë për shoqëri qytetare", thotë Malevska. Sipas saj, koalicioni partiak qytetar midis LSDM-së dhe BDI-së është një hap përpara dhe është veprim pozitiv që të dy partnerët ranë dakord për një kandidat të përbashkët dhe platformë politike të përbashkët, të cilat duhet dhe t'i zbatojnë nëse kandidati i tyre i fiton zgjedhjet presidenciale më 5 maj.

"Të gjithë janë për BE dhe NATO, mirëpo ku u vendosën kushte edhe kjo dihej shumë më parë, nevoja për konsensus që të zgjidhet problemi me Greqinë dhe fqinjët tjerë, kjo më parë nuk u arrit. Nuk është e nevojshme në mënyre verbale të deklaroni se jeni për NATO dhe BE kur i dini saktë se cilat kushte duhet t'i plotësoni. Kur tani një garniturë politike në koalicion me partinë shqiptare ia arriti qëllimin të mbyll kontestin 30 vjeçar në një afat të shkurtër, të cilin partia më e madhe opozitare e cila ishte në pushtet nuk arriti ta zgjidh më shumë se një dekadë. Tani partia në opozitë në praktikë bënë hapa të gabuara që shkojnë në drejtim të opstrukcionit të marrëveshjes së arritur midis Maqedonisë dhe Greqisë, për të cilën garantë është bashkësia ndërkombëtare për implementimin e plotë të marrëveshjes", thotë Malevska.

Poziviteti i këtyre zgjedhjeve presidenciale është se për herë të parë kemi dy koncepte te kundërta. Sipas analistit politik Albert Hani, koncepti i parë është se po tenton t'i çojë në harresë elementet nacionaliste dhe armiqësore, ndërsa koncepti i dytë që edhe më tepër e nxitë nacionalizmin tek maqedonasit dhe shqiptarët.

"Konceptin qytetar që e promovon kandidati konsensual është shuplaka e fundit që qytetarët të kenë një diversitet të mendimeve të ndryshme dhe të mendojnë për ardhmërinë e gjeneratave të reja dhe koncepti i kandidatëve të partive opozitare që edhe më tepër promovon konceptin e ideve nacionaliste", thotë Hani.

Mirëpo, vazhdon Hani, kësaj radhe votuesit shqiptarë nëse e votojnë kandidatin konsensual për president, është e udhës që presidenti i ardhshëm më të vërtetë të përmbush konceptin qytetarë dhe shqiptarët të kenë të drejta të njëjta si në aspektin kulturor, gjuhësor dhe sundim të shtetit të drejtësisë, të jetë i barabartë për të gjithë qytetarët pa marrë parasysh se cilit etnitet i takojnë.

"Edhe sikur të votohet në rrethin e parë kandidati shqiptar për president, apo në rrethin e dytë edhe sikur shqiptarët ta votojnë përsëri - nuk mund president shteti të behët vetëm me votat e shqiptarëve. Dhe e kundërta - as kandidati maqedonas pa votat e shqiptarëve nuk bëhet president. Prandaj duhet të kemi kujdes kur shqiptarët e japin votën se mos të votojnë një kandidat për president shteti siç e kishim presidentin në dy mandatet e mëparshme", thotë Albert Hani, analist politik.

BDI: Edhe Dollneni rreshtohet pas konsensualitetit

Shkup, 5 prill - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) në vazhdën e aktiviteteve që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore për zgjedhjen e presidentit të ri të shtetit për këtë vit, kanë qëndruar në Zhitosh të Komunës së Dollnenit. Para anëtareve, simpatizantëve të BDI-së, ishin prezent, ministra, zëvendëskryeministra të kësaj partie të cilët ju drejtuan të pranishmëve se vota e dhënë për presidentin konsensual hap rrugën që në të ardhmen ky pozicion të ju takoj shqiptarëve. Ish deputeti i kësaj zone, Musa Ibrahimi u shpreh se siç e dimë për të parin e shtetit janë tre kandidatë ku BDI-ja mbështet kandidatin konsensual i cili deklaron se procesin për integrim për në NATO dhe BE do ta zbatojë pa e penguar. "Aty ku e kemi interesin tonë, në NATO dhe BE, vetëm ashtu e shoh perspektivën time, të

familjes sime dhe shoqërisë sonë në tërësi. Prandaj ne do të mbështesim kandidatin konsensual Pendarovski i cili është i renditur në listën për votim me numrin 3 sepse aty e gjejmë edhe konceptin e Bashkimit Demokratik për Integrim të nisur qysh në vitin 2014", theksoi ish deputeti, Musa Ibrahimi. ndërkohë dje kanë vazhduar takimet me qytetarët nga ana e Bashkimit Demokratik për Integrim edhe atë në katër qytete, Ohër, Strugë Manastir dhe Prespë ku qytetarët e të tre këtyre qyteteve do të njofton për rëndësinë e zgjedhjes së presidentit konsensual.

ZAEVI PËR FUSHATËN E DERITANISHME

Siljanovska të distancohet nga e kaluara e VMRO-së

Shkup, 5 prill - Duhet të kemi fushatë zgjedhore pozitive, kam edhe të drejtë edhe obligim të mbështes koncept dhe kandidat për zgjedhjet, i respektoj të gjithë kandidatët edhe asnjëherë asnjërin nuk e ka nënçmuar, thotë kryeministri Zoran Zaev, pas vlerësimit që dje e dërgoi kandidatja për president Gordana Siljanovska se është e pazakontë që kryeministri dhe ministra të marrin pjesë në fushatë për president dhe se të gjithë duhet të sillen në mënyrë teknike. "Unë jam edhe kryetar i LSDM-së, dhe gjithsesi kemi të drejtë të kemi përcaktim dhe qëndrim tonin. Unë jam njëri ndër shtytësit e të majtës dhe të shumicës qeveritare. Në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në vendin tonë, kemi bërë zgjedhje të kandidatit pas të cilit qëndrojmë. Qëndroj hapur, me nder dhe publikisht për të gjithë konceptin e Stevo Pendarovskit dhe pas Pendarovskit, sepse jo vetëm që është e drejta ime, por është edhe detyrë dhe obligim i imi të mbështes koncept dhe kandidat në këto zgjedhje. Respekt dhe nderim për të gjithë kandidatët, asnjëherë askënd nuk e kam nënçmuar, por qytetarët duhet të zgjedhin midis ofertës dhe konceptit", deklaroi Zaevi, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve. Ai bën apel që t'u jepen oferta qytetarëve dhe të ketë fushatë pozitive në të cilën janë obliguar kandidatët presidencialë.

"Bëj apel që t'u jepen oferta qytetarëve, e jo vetëm të flitet bosh për një të kaluar. Madje edhe kur flitet për të kaluarën, është mirë që të distancohemi nga ajo e kaluar siç këtë zonja Silanovska në fakt edhe nuk e bën. Në një aspekt të tillë pres fushatë pozitive sepse ajo që edhe ishte premtuar më 1 prill nga zonja Siljanovska dhe zoti Mickoski, sado që është dita e shakasë, ne nuk e kemi me shaka. Duhet të ketë fushatë pozitive që të munden qytetarët të zgjedhin koncept të vërtetë dhe president të vërtetë, i cili sipas Kushtetutës dhe sipas ligjit është njeriu i parë në shtet", tha Zaevi, i cili mori pjesë në konferencën rajonale të Lidhjes së Klubeve Rotari të RMV: "Ekonomia kombëtare në prag të BE-së – sfida dhe përvoja". Kryeministri është edhe kryeministër i imi dhe të gjithë duhet të sillen teknikisht, tha Siljanovska Davkova, kandidatja e VMRO-DPMNE-së opozitare, gjatë TV debatit të mbrëmshëm me dy kandidatët e tjerë Stevo Pendarovskin të LSDM-së dhe Blerim Rekën, i cili mbështetet nga Lëvizja Besa dhe Aleanca për Shqiptarët.

TRIBUNË E ORGANIZUAR NGA ITSHKSH

PËRKUJTOHET 20 VJETORI I EKSODIT MASIV TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS

Shqiptarët ndër shekuj nuk janë kujdesur që kujtesën historike ta ruajnë dhe ta përdorin si argument para ndërkombëtarëve për shtet ndërtimin, shtoi Asani, duke theksuar se për të mos humbur historia e dhimbshme e Kosovës do të hapet një Qendrën Përkujtimore e Eksodit "Bllaca 1999"

Koha — Delvina KËRLUKU

Shkup, 5 prill - Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITSHKSH) në Shkup mbajti tribunën e organizuar me rastin e 20-vjetorit të eksodit masiv të shqiptarëve nga Kosova. Gjatë luftës në Kosovë, në vitet 1998/99, rreth një milion shqiptarë u detyruan nga forcat ushtarake e policore serbe të shpërnguleshin në Shqipëri dhe Maqedoni dhe vende të tjera. Përveç të shpërngulurve në Shqipëri dhe Maqedoni, mijëra shqiptarë kaluan kufirin edhe me Malin e Zi, ndërsa qindra mijëra ishin zhvendosur nga shtëpitë e tyre për të gjetur strehim në malet e Kosovës.

Eksodi, apo dëbimi i shqiptarëve me dhunë nga vatrat e tyre, arriti kulmin pas fillimit të bombardimeve të NATO-s kundër pikave ushtarake dhe policore të ish-Jugosllavisë, u tha në këtë tribunë, udhëhequr nga historiani Sevdail Demiri.

Skënder Asani, drejtor i ITSHKSH-së , përmendi ngjarjet historike të shqiptarëve që kanë ndodhë gjatë shek. XIX deri në vitin 1999, shpërnguljet nga trojet e tyre.

"Pas Luftës së II Botërore, mendohej se filloi një erë e re edhe për shqiptarët, por nuk ndodhi ashtu. Në trevat shqiptare nga viti 1945 – 1999 ne kemi mbi 1 milion shqiptar të shpërngulur nga trevat e tyre etnike, po ashtu kemi me mijëra të vrarë dhe të burgosur, të cilët nuk pajtoheshin me regjimet e atëhershme. Viti 1999 ishte vazhdimi i strategjive famëkeqe të serbëve ndaj shqiptarëve. Intervenimi i NATO-s, ishte një veprim humanitar, sepse bota e kuptoi se po ndodh një gjenocid i ngjashëm si në Bosnjë Hercegovinë", tha Asani.

Shqiptarët ndër shekuj nuk janë kujdesur që kujtesën historike ta ruajnë dhe ta përdorin si argument para ndërkombëtarëve për shtet ndërtimin, shtoi Asani, duke theksuar se për të mos humbur historia e dhimbshme e Kosovës do të hapet një Qendrën Përkujtimore e Eksodit "Bllaca 1999", në Shkup.

Jahja Lluka, kryetar i Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve nga Trojet e Veta në Prishtinë tha se lufta në Kosovë ka qenë vazhdim i projektit të Garshaninit, kurse planet e serbëve dhe bëmat e shqiptarëve nuk duhet të harrohen dhe brezi i ri duhet të ndërgjegjësohet mbi historinë tragjike të shqiptarëve. Tani është ndërmarrë një iniciativë bashkë me qeverinë e Kosovës për ngritjen e një muzeut në Shkup. "Qeveria e Kosovë ka marrë një vendim të tillë dhe ka nda një buxhet, që besoj në bashkëpunim me qeverinë e shtetit tuaj, ku edhe kanë shtri dorën e bashkëpunimit ministritë e Arsimit të dy shteteve, për hapjen e qendrës së gjenocidit", tha Lluka.

Sekretari gjeneral i Kryqi i Kuq, Sait Saiti tha se kjo organizatë ka pasur një rol të rëndësishëm në ndihmesën e refugjatëve të Kosovës.

"Kriza e madhe filloi që nga viti 1998 dhe prej muajit gusht deri në fund të vitit, janë evidentuar diku 800 persona, gra dhe fëmijë. Fluksi më i madh vjen në fillim të vitit 1999, me 440.000 persona. Ndërsa nga statistikat tona del që në atë kohë, nga Kosova, janë largua rreth 920.000 persona. Nga numri i përgjithshëm, vetëm 60 për qind janë vendosur nëpër familjet shqiptare, pjesa tjetër është vendosur në kampe, si kampi i Stenkovecit, Çegranit dhe Bojanës, nëpër qendra, institucione të ndryshme të vendit. Nga anëtarët e humbur të familjeve, janë dërguar 6.946 porosi në Kryq të Kuq të Maqedonisë", tha Saiti.

Zeqirja Ibrahimi, bashkëpunëtor i lartë shkencor në ITSHKSH, tha se lufta në Kosovë ka pasur për qëllim spastrimin etnik, por kjo luftë triumfoi për shqiptarët dhe brezat e rinj duhet të vetëdijesohen të mos e harrojnë kurrë historinë e dhimbshme të kombit të vet.

Ndryshe, të dhënat flasin se 20.000 gra shqiptare kanë qenë të përdhunuara. 2467 persona janë zhdukur, ndërsa në Maqedoni 120 persona janë akoma pa status të zgjedhur.

RASMUSEN PËR MARRËVESHJEN GREQI-MAQEDONIA E VERIUT

Vizion i përbashkët strategjik

Athinë, 5 prill - Në qershor ose më së voni në fillim të vjeshtës do të duhet të bisedojmë t'i sigurojmë aspektet evropiane për vendet siç janë Maqedonia e Veriut, ka porositur kryeministri danez, Lars Loke Rasmusen pas takimit në Athinë me kolegun e tij grek Aleksis Cipras dhe ka theksuar se vizita e kryeministrit grek në Shkup tregon se dy vendet kanë vizion të përbashkët strategjik.

Dy kryeministrat, përveç raporteve bilaterale, për problemin e migrimit dhe të Bregzitit, kanë biseduar edhe për perspektivën evropiane të shteteve të Ballkanit Perëndimor si dhe për Marrëveshjen e Prespës, njofton korrespodenti i MIA-s në Athinë. "E shfrytëzoj këtë mundësi të falënderojë kryeministrin grek për përpjekjet e rëndësishme që të zgjidhet kontesti disavjeçar me Maqedoninë e Veriut. Çështja është zgjedhur, vendi do të hyjë në NATO. Flasim për përpjekje historike, ndërsa vizita juaj në Shkup, konfirmon se dy vendet kanë vizion strategjik të përbashkët. Kjo ka kontribuuar në stabilitetin e rajonit", ka thënë Rasmusen.

Ai e ka uruar Ciprasin për "guximin politik që e tregoi në këtë çështje" dhe është kthyer në perspektivën evropiane të Maqedonisë së Veriut. "Pajtohem se në qershor ose më së voni në fillim të vjeshtës të bisedojmë që të shohim se si mund të sigurojmë aspektet evropiane për vendin siç është Maqedonia e Veriut, që të mbledhim frytet të asaj që e keni realizuar", ka porositur kryeministri danez. Aleksis Cipras në takim ka njoftuar Rasmusenin për nismat greke për bashkëpunim në veri dhe në jug.

"Bashkëpunimet trilaterale me Qipron, Izraelin, Egjiptin, Jordanin dhe Palestinën por edhe në anën tonë në veri me Bullgarinë, Rumaninë, Serbinë, Marrëveshja historike e Prespës me fqiun tonë verior Maqedonia e Veriut... Në këto korniza biseduam për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor", ka thënë kryeministri grek.

Micotakis thotë se do ta revidojë Marrëveshjen e Prespës

Athinë, 5 prill - Në politikë ekzistojnë punë të cilat bëhen dhe nuk tregohen dhe mbetem me vlerësimin tim, thotë kryetari i Demokracisë së Re, Kirjakos Micotakis, në intervistën për televizionin grek Open lidhur me qëndrimin e tyre se Cipras ka bërë këmbim me evropianët për Marrëveshjen e Prespës. Njeriu i parë i partisë më të madhe opozitare greke shton se nuk ka kurrfarë dyshimi për atë, ndërsa për Marrëveshjen e Prespës potencoi se ai është absolutisht konsekuent mbi atë që ka thënë, ndërsa nëse e fiton besimin e qytetarëve, thotë se "mund t'i zbusim disa prej aspekteve negative të kësaj marrëveshje". "Do të luftojmë që t'i zbusim pasojat negative të kësaj marrëveshje. Do t'i mbështesim produktet e Maqdonisë, do të luftojmë ta mbështesim brendin e Maqedonisë së vërtetë greke. Detyrë e jona është ta bëjmë këtë, pasi sot, kjo marrëveshje në esencë, çfarë bën? Në esencë, në mënyrë eksklusive ia dha mbiemrin maqedonas, identitetin maqedonas, vdendit fqinj", tha Micotakis dhe shtoi se nëse do të dëshironin marrëveshje të tillë, kanë mundur ta arrijnë që para 11 vitesh në Bukuresht. Lideri i Demokracisë së Re e përsëriti qëndrimin e tij se pse vlerëson se marrëveshja është e keqe, duke shpjeguar se është në kundërshtim me shoqërinë greke. "Askush nuk mu përgjigj, as zoti Cipras, pse një vend i cili quhet Maqedonia e Veriut, duhet gjuha e tij të jetë maqedonase, ndërsa qytetarët maqedonas? Kësaj pyetje akoma askush nuk i është përgjigjur edhe zoti Cipras nuk mund të përgjigjet pasi ky është fitim i madh zotit Zaev. Prandaj zoti Zaev krenohet se gjoja e ka dhënë, mendon ka bërë lëshim të madh, emrin Maqedonia e Veriut dhe e fitoi atë që asnjë Qeveri greke në të kaluarën nuk ia dha, gjuhën maqedonase, nacionalitetin maqedonas, identitetin maqedonas", theksoi kryetari i partisë më të madhe opozitare greke.

"Pohimet tona nga fillimi se mbi Prokurorinë e Shkupit është kryer presion për rikualifikimin e lëndës nga vepër penale 'dhunë' në atë 'vrasje mizore' i vërtetoi së fundmi edhe deputeti Pavle Bogoevski. Ky nuk është ndikimi i vetëm që është bërë për ndryshimin e akuzës", thotë për KOHA, avokati Asmir Alispahiç

PAS DEKLARATËS SË DEPUTETIT BOGOEVSKI, MBROJTJA ME KËRKESË TË RE

TË PËRJASHTOHET PROKURORI FIDOVSKI

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 5 prill - Pala mbrojtëse e të akuzuarve Besir Bela dhe Skender Demiri, në rastin "Sazdovski", kërkon shkarkimin e prokurorit të lëndës, Anel Fidovski. Kjo kërkesë e tyre, siç njoftojnë avokatët e Belës dhe Demirit, vjen si rezultat i deklaratës së deputetit të koalicionit të LSDM-së, Pavle Bogoevski, i cili në një debat televiziv, publikisht pranoi se ka reaguar dhe udhëzuar se si duhet trajtuar rasti. Avokatët mbrojtës vlerësojnë se kjo është ndikim në punët e Prokurorisë së Shkupit dhe për këtë arsye, kërkojnë largimin e prokurorit Fidovski nga shqyrtimi i mëtutjeshëm i lëndës.

"Zyrtarisht më 2 prill, gjatë seancës së fundit, në procesverbal para Trupit gjykues kemi kërkuar që prokurori Anel Fidovski, të shkarkohet nga lënda për rasti 'Sazdovski'. Përpos kësaj, më 3 prill, edhe zyrtarisht me shkrim kemi kërkuar nga Prokuroria e Lartë që të pranojë një kërkesë të tillë. Pohimet tona nga fillimi se mbi Prokurorinë e Shkupit është kryer presion për rikualifikimin e lëndës nga vepër penale 'dhunë' në atë 'vrasje mizore' i vërtetoi së fundmi edhe deputeti Pavle Bogoevski. Ky nuk është ndikimi i vetëm që është bërë për ndryshimin e akuzës", thotë për KOHA, avokati Asmir Alispahiç.

Deputeti i koalicionit të LSDM-së, Pavle Bogevski, gjatë debatit në emisionin Klik Plus në TV 21, (më 28 mars) ku përbal-



PAVLE BOGOEVSKI

Po, kam qenë ndër të shumtit që kam shprehur habinë me veprimin e institucioneve. Por, këtu nuk shoh asnjë ndikim. Dhe nuk shoh arsye pse prokuroria dhe gjykata nuk do të kishin mundur ta ruajnë pavarësinë. Nuk jam përzier dhe nuk kam ndikuar

lë kishte Vladimir Nelloskin nga VMRO-DPMNE, u lavdërua se gjatë kohës kur kishte ndodhur ngjarja me të ndjerin Nikolla Sazdovski, ai përmes rrjetit social Fejsbuk kishte reaguar dhe udhëzuar se si duhet trajtuar e gjithë ngjarja.

"Kur ishte 'Rasti Sazdov', unë isha ndër të parët i cili thashë se kualifikimi për 'dhunë' si vepër ndoshta është pak nënçmues. Atëherë në ato momente ende nuk kishte pasojë vdekje dhe kuptohet se nuk mundej të cilësohej si vrasje. Por, kishte çështje që duhej shqyrtuar, si forma e kualifikuar e kështu me radhë. Isha ndër më të zëshmit ku jepja kritika dhe mendime për atë se si duhet dhe si mundet të udhëhiqet hetimi, respektivisht cila do të ishin hapat e institucioneve", thotë deputeti Bogoevski. Por dje, ndryshe thotë Bogoevski.

Duke folur për gazetën KOHA, deputeti i koalicionit të LSDM-së pranon se ka qenë ndër të shumtit që publikisht e ka shprehur habinë për veprimin e institucioneve, megjithëse thotë se nuk ka ndërhyrë në pavarësinë e gjyqësorit. "Po, kam qenë ndër të shumtit që kam shprehur habinë me veprimin e institucioneve. Por, këtu nuk shoh asnjë ndikim. Dhe nuk shoh arsye pse prokuroria dhe gjykata nuk do të kishin mundur ta ruajnë pavarësinë. Nuk jam përzier dhe nuk kam ndikuar", tha shkurt Bogoevski. Seanca e radhës për rastin "Sazdovski" është caktuar të mbahet me datë 12 prill. Deri atëherë, ose gjatë kësaj seance pritet të dihet se vallë do të pranohet apo jo kërkesa e avokatëve të Belës dhe Demirit që prokurori në fjalë të përjashtohet.

Ndërkohe, arsye tjetër e cila mendohet se ka ndikuar në rikualifikimin e veprës penale në rastin e të ndjerit Nikolla Sazdovski janë edhe protestat e organizuara nga grupi i tifozëve "Komiti". Pas vdekjes së Sazdovskit, nëpër rrugët e Shkupit, gjatë muajve korrik dhe gusht të vitit të kaluar u organizua një sërë protestash, të cilat zakonisht përfundonin para Prokurorin Publike.

Ndryshe, në seancën e fundit, nga avokati Naser Raufi u kërkua edhe shkarkimi nga lënda e kryesues së Trupit gjykues, gjykatëses Daniella Aleksova. Sipas avokatit Raufi, qasja e gjykatëses Aleksova gjatë gjithë kohës ka qenë e njëanshme dhe e padrejtë. Mirëpo, kjo kërkesë e tij (e dyta gjatë këtij procesi gjyqësor) u refuzua si e pabazë.

Deri më tani, në procesin gjyqësor për rastin "Sazdovski" janë prezantuar një sërë dëshmish materiale dhe verbale, përfshi edhe deklaratat e të akuzuarve, gjegjësisht rikonstruimi i ngjarjes.

Nëntë padi penale për zjarrvënie të qëllimshme

Shkup, 5 prill - Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski informoi se deri tani MPB ka dorëzuar nëntë padi penale për zjarrvënës në shtet. Sipas tij, ka indikacione serioze se përveç interesave të biznesit, ndodhin zjarre edhe nga pakujdesia, megjithatë edhe për arsye politike.

"Konkretisht, konsiderojmë se ajo që ndodhi në sallën "Boris Trajkovski", është zjarr i qëllimshëm, duke konsideruar se këtu do të mbahet konventa e njërës parti politike. Seriozisht punojmë në detektimin e të gjitha informacioneve të cilat i marrim, shkojnë në atë drejtim se është e mundur të ketë përzierje politike", deklaroi Spasovski pas shënimit të sotëm të 15 vjetorit të Qendrën Rajonale MARRI.

Ai ka apeluar deri te qytetarët të përmbahen nga shkatërrimi i natyrës dhe nga çdo motiv të shkaktojnë zjarre dhe shkatërrime në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sepse, paralajmëroi, për atë vijon përgjegjësi serioze.

KRONIKË

Në aksident trafiku lëndohen katër persona

Të enjten rreth orës 14 e 20 minuta, në rrugën rajonale Grupçin – Tetovë, në afërsi të kthesës për Zhelinë, veturë e tipit Pezho 306 me targa të Tetovës, e drejtuar nga 23 vjeçari A.S nga Grupçini, ka humbur kontrollin dhe ka dalë nga rruga dhe ka goditur një shtyllë prej betoni, ku kanë qenë të vendosur disa shenja komunikacioni. Me këtë rast, katër bashkudhëtarë kanë marrë lëndime. Bëhet fjalë për personat E.I 23 vjeçar, E.Sh 18 vjeçar, F.B 30 vjeçar dhe A.S 18 vjeçar nga Grupçini. Të njëjtit me veturë tjetër janë dërguar për ndihmë mjekësore në Spitalin klinik të Tetovës. Është kryer hetim dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Qentë endacakë kafshojnë një 17 vjeçar

Një 69 vjeçare nga Gostivari me iniciale D.G, të enjten ka denoncuar se një natë më parë, në parkun që ndodhet në rrugën "Major Çede Filipovski" në Gostivar, djali i saj 17 vjeçar duke u kthyer në shtëpi është sulmuar nga qentë endacakë dhe është kafshuar në këmbën e majtë. Rastet e këtilla të kafshimit të qenve endacakë janë shpeshtuar kohëve të fundit si në qytetin e Gostivarit po ashtu edhe në Tetovë.

Shkup, nëntë aksidente me 11 të lënduar

Njëmbëdhjetë persona kanë marrë lëndime të lehta në pesë nga gjithsej nëntë aksidente që kanë ndodhur gjatë 24 orëve të kaluara në rajonin e Qytetit të Shkupit. Në Katër aksidente është shkaktuar dëm material. SPB-Shkup ka informuar se nga trafiku janë përjashtuar gjatë shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, 23 shoferë para se të marrin të drejtën e drejtimit të automjetit, dy fillestarë dhe 27 automjete të paregjistruara. Policia ka gjobitur edhe 26 shoferë të cilët kanë biseduar në celular, 15 shoferë për shkak të mosmbajtjes rripit të sigurisë dhe pesë shoferë të motorit, mopedit apo motoçikletës për shkak të mosmbajtjes së kaskës mbrojtëse. Janë ndërmarrë masa edhe kundër tre shoferëve të cilët kanë kaluar në dritë të kuqe, tre shoferë të cilët nuk kanë dhënë përparësi për kalimin e këmbësorëve në vendkalimin e shënuar për këmbësorë, tre shoferë për rreshtim të parregullt dhe dy shoferë për parakalim të parregullt. Janë sanksionuar edhe dy këmbësorë të cilët kanë bërë kundërvajtje. Për parkim të parregullt janë lëshuar 121 masa, ndërsa me automjetin special "karrotrec" janë larguar 70 automjete. *(U.H)*

OPTIMIZËM I KRYEMINISTRIT KUNDREJT RAPORTEVE NDËRKOMBËTARE

TË FUNDIT ME RRITJEN EKONOMIKE

"Gazifikimi është në rrjedhë e sipër me intensitet të plotë, ndërsa tërësisht është liruar edhe hekurudha që përbën 75 për qind të investimeve kapitale në shtet. Pjesa e mbetur prej 25 për qind do të lëvizet me kanalizimet, çerdhet dhe shkollat. Vetëm me mëngë të përvjelur dhe punë të mirë mundet edhe të tejkalojmë parametrat e përcaktuar", theksoi Zaevi

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 5 prill - Ekzekutivi mbetet optimist për rritje më të madhe ekonomike seç parashikojnë institucionet ndërkombëtare si Banka Botërore prej 2.9 për qind apo Instituti ekonomik i Vjenës prej 3 për qind. Sipas kryeministrit Zoran Zaev, më shumë tregues ekonomik, konkretisht projektet e ndryshme infrastrukturore si lidhja hekurudhore me Bullgarinë, tregojnë se ekonomia vendore po ec para me hapa të përshpejtuar.

"Gazifikimi është në rrjedhë e sipër me intensitet të plotë, ndërsa tërësisht është liruar edhe hekurudha që përbën 75 për qind të investimeve kapitale në shtet. Pjesa e mbetur prej 25 për qind do të lëvizet me kanalizimet, çerdhet dhe shkollat. Vetëm me mëngë të përvjelur dhe punë të mirë mundet edhe të tejkalojmë parametrat e përcaktuar", theksoi Zaevi. Njëherësh, tha ai, në dy muajt e parë të vitit shënohet rritje e prodhimtarisë industriale për 11 për qind, si dhe shënohet edhe rritje prej 25 për qind e eksportit në zonat industriale, ndërsa përmendi edhe rritjen për 312 për qind të investimeve kapitale në rrugët shtetërore apo nga 980 milionë denarë në vitin e kaluar në 2.8 miliardë denarë këtë vit vetëm në tremujorin e parë të vitit. Komentet në fjalë Zaevi i bëri në konferencën rajonale të organizuar nga klubit Rotari të titulluar "Ekonomia nacionale - sfidat dhe përvojat e anëtarësimit në BE".

Zaevi më tej theksoi se Oda Ekonomike Gjermane me të drejtë ka reaguar "kur ne si majtistë dhe socialdemokratë miratojmë vendime të caktuara si paga minimale, megjithatë obligimi i jonë si qeveri është që krahas biznesit dhe ekonomisë, të ndihmojmë edhe varfërinë".

"Besoj se të gjithë së bashku do të shohim pas përfundimit të gjashtëmujorit se kjo paraqet një situatë fituese për të dyja palët ku fitojnë edhe të varfrit, por edhe ekonomia dhe afaristët", shton më tej ai. Në ndërkohë, institucionet relevante të jashtme financiare theksojnë se Maqedonia e Veriut do të ketë një rritje ekonomike ndër më të dobëtat në rajon. Bile rritje më të madhe se ne në periudhën 2019-2021 do të ketë Kosova dhe Shqipëria, vlerëson Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike në raportin më të fundit për ekonomitë e 23 vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore. Sipas këtij raporti, rritja ekonomike e Shqipërisë dhe e Kosovës do të jetë më e shpejta në rajon me nga 3.8 për qind sivjet në vitin 2020 dhe me 3.4 për qind në vitin 2021. Kosova nga ana tjetër do të ketë rritje ekonomike prej 4.1, 4 dhe 3.9 për qind në këtë periudhë trevjeçare. Rritje të ngjashme ekonomike me ne do të ketë Serbia me 3.4 për qind, ndërsa rritje më të dobët do të ketë Bosnja me një mesatare prej 2.5 për qind dhe Mali i Zi me 2.2 për qind. Nga ana tjetër, vlerësohet se pas përmirësimit të perspektivave politike, Maqedonia e Veriut në periudhën e ardhshme nevojitet më shumë të fokusohet në reformat ekonomike me qëllim të përshpejtimit të procesit të anëtarësimit dhe konversionit në BE.

"Nevojitet edhe përmirësimi i menaxhimit dhe efikasitetit të administratës publike për të siguruar shërbime më të mira për qytetarët dhe firmat, të sigurohet sundimi i së drejtës, përfshi edhe marrëveshjet komerciale, përforcimi i konkurrencës së firmave përmes teknologjive të reja", thotë ekonomistja e Bankës Botërore, Sanja Magjareviq-Shujster.

Në këtë drejtim nevojitet përmirësimi i efikasitetit të harxhimeve publike si përforcimi i të ardhurave tatimore, përmirësimi i efikasitetit të harxhimeve në shëndetësi, racionalizimi i subvencioneve, përmirësimi i menaxhimit me financat publike si dhe rritja e llogaridhënies me qëllim që të pengohet krijimi i borxheve të reja. Nevojitet edhe përmirësimi i menaxhimit me investimet publike që duhet të orientohen ndaj cilësisë dhe qëndrueshmërisë.

Bie eksporti, rritet importi

Shkup, 5 prill - Vlera e përgjithshme e eksportit të mallrave nga Republika e Maqedonisë së Veriut, në periudhën janar-shkurt të këtij viti është 1.075.052.000 dollarë dhe shënon rënie prej një për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlera e mallrave të importuara, në periudhën e njëjtë, është 1.416.730.000 dollarë, që është për 1.3 për qind më shumë në krahasim me dy muajt e parë të vitit të kaluar. Deficiti tregtar, në periudhën janar - shkurt të këtij viti, është 341.678.000 dollarë. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, mbulimi i eksportit dhe importit është 75.8 për qind. Në dy muajt e parë të këtij viti më shumë është tregtuar me Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Greqinë, Serbinë dhe Italinë.

HULUMTIM I KOMPANISË "PAKOMAK"

Të rinjtë me më pak kulturë në selektimin e mbeturinave

Shumica e qytetarëve të cilët selektojnë në përgjithësi plastikë është (82 për qind) por edhe qelq (42 për qind) të cilat i konsiderojnë si lloj i veçantë i mbeturinave për selektim. Pastaj vijon letra me (34 për qind). Ata qytetarë të cilët kanë deklaruar se asnjëherë nuk selektojnë mbeturina, konsiderojnë se arsye kryesore për atë janë mungesa e kontejnerëve për selektim

Shkup, 5 prill - Është rritur vetëdija te qytetarët për selektim të mbeturinave, por të rinjtë prej moshës 18 deri në moshën 30 vjeçare në numër dukshëm më të vogël selektojnë mbeturina, tregon hulumtimi më i ri i bërë nga ana e kompanisë "Pakomak" gjatë muajit shkurt të këtij viti. Rezultatet e analizës së bërë tregojnë se ekziston përparim në ngritjen e vetëdijes për selektim të mbeturinave, përkatësisht diçka më shumë se një e treta e qytetarëve në qytetet më të mëdha në shtet kanë zhvilluar shprehi gjithmonë ose shpesh herë të selektojnë mbeturina, që në krahasim me vitin 2017 paraqet rritje për 3.1 për qind. Kjo do të thotë se katër prej 10 qytetarëve gjithmonë ose shpesh herë selektojnë mbeturina. Këtë vit, Prilepi dhe Strumica janë qytetet në të cilat qytetarët më së shumti selektojnë mbeturina për dallim nga viti 2017 kur ka udhëhequr Manastiri dhe Shkupi. Sipas analizës, gratë dhe qytetarët e moshës mbi 45 vjet më shumë selektojnë mbeturina sesa burrat dhe popullata më e re e moshës deri 45 vjet.

Është e bindshme që shumica e qytetarëve të cilët selektojnë në përgjithësi plastikë është (82 për qind) por edhe qelq (42 për qind) të cilat i konsiderojnë si lloj i veçantë i mbeturinave për selektim. Pastaj vijon letra me (34 për qind). Ata qytetarë të cilët kanë deklaruar se asnjëherë nuk selektojnë mbeturina, konsiderojnë se arsye kryesore për atë janë mungesa e kontejnerëve për selektim (79 për qind), si dhe mungesa e shprehisë për atë (35 për qind). Megjithatë, nga viti 2017 deri në vitin 2019, perceptimi për arritshmërisë të kontejnerëve për selektim të mbeturinave është rritur prej dy në tre nga dhjetë qytetarë.

Prilepi, Ohri, Shkupi dhe Manastiri janë qytetet ku, sipas mendimit të qytetarëve, arritshmëria e kontejnerëve është më e madhe në krahasim me qytetet tjera. Nga qytetarët të cilët kanë deklaruar se nuk kanë kontejnerë të mjaftueshëm, 94 për qind kanë deklaruar se do ta shfrytëzonin kontejnerin përderisa bëhet i arritshëm për to. Ky qëllim i përdorimit, siç citojnë nga kompania, duhet të merret me rezervë sepse qytetarët shpesh herë japin "përgjigje të pranueshme sociale": Në lidhje me informimin dhe kënaqësinë e kompanive të cilat janë kompetente për selektim dhe reciklim të mbeturinave shumicë e madhe (76 për qind) e qytetarëve konsiderojnë se ndërmarrjet komunale publike janë kompetente për selektim të mbeturinave për reciklim. Këtë vit, me anketën ishin përfshirë një numër i madh i të anketuarve nga grupmosha të ndryshme, në një numër të madh të qyteteve, ndërsa është rritur edhe pyetësori i anketës. *(Q.A)*

SFIDAT E MIGRACIONIT

MIJËRA MIGRANTË PRAPA DYERVE TË MAQEDONISË SË VERIUT

Trendi i përpjekjeve ilegale të migrantëve janë rritur, por në vitin 2018, janë penguar dhe ndaluar të kalojnë kufirin ilegalisht mbi 16900 migrantë. Sipas ministrit të Brendshëm, Oliver Spasovski, kjo flet për një trend në rritje, por edhe se kemi një mbrojtje të mirë të kufirit maqedono-grek

Koha Destan JONUZI

Shkup, 5 prill - Migrantët ilegal edhe më tej paraqes sfidë për Maqedoninë e Veriut dhe Ballkanin Perëndimor. Autoritetet nuk përjashtojnë mundësinë për lëvizje të reja. Në anën tjetër të kufirit me Greqinë, nga dita e enjte janë stacionuar rreth 1500 migrantë, ndërsa 500 janë afruar deri në Selanik. "Një nga sfidat që është tani dhe që do të ekzistojë edhe më tej sigurisht se është migrimi. Rruga përmes Maqedonisë në Serbi dhe në vendet tjera për një kohë të gjatë nuk përdorët nga migrantët. Tani ata lëvizin përmes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnje Hercegovinës, ose nga Shqipëria në Itali dhe më tej drejt vendeve të Evropës. Ne bashkëpunojmë në këtë pjesë me shtetet e rajonit dhe Bashkimin Evropian (BE), politikat e së cilës i ndjekim edhe me ballafaqimin me krizat e migrantëve. Jemi të gatshëm t'i përgjigjemi çdo sfide që është para nesh. Lidhur me rritjen e numrit të migrantëve të cilët mblidhen në kampin në Greqi shkëmbejmë për çdo ditë informacione me kolegët nga pala greke. Mbledhja më e madhe nëpër kampet në Greqi ka nisur nga dita e enjte, ne me plane të veçanta e kemi përforcuar sigurinë të kufirit shtetëror midis Republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut", deklaroi ministri i Punëve të Brendshëm (MPB), Oliver Spasovski, pas brifingut diplomatik për aktivitetet e Iniciativës rajonale për azil, refugjatë dhe emigracion - MARR-i.

Ai bëri të ditur se veprohet sistematikisht, varësisht prej informacioneve që vijnë dhe se bëhet fjalë për 1200 deri në 1500 migrantë që janë në kampet greke në kufirin me Maqedoninë e Veriut. "Për momentin kolegët grek e kontrollojnë atë numër, por megjithatë ne e kemi për obligim që të jemi të përgatitur që ta mbrojmë kufirin dhe hyrjen eventuale në shtetin tonë", theksoi Spaskovski. Nga ana tjetër, Sashko Kocev, drejtor i Iniciativës rajonale për azil, refugjatë dhe emigracion - MARR-i, tha se për momentin ndodhen deri në 1500 migrantë në Greqi, ndërsa rreth 500 në afërsi të Selanikut.

"Ka informacione për përleshje me policinë greke, situata për momentin është nën kontroll, por nëse krahasohet me vitin 2015, mendojë se ajo situatë nuk do të përsëritet. Shtetet janë më të përgatitura tani, ekziston mbështetje e madhe nga BE-ja për ballafaqimin me krizën e migrantëve dhe në kufirin tonë jugor me Greqinë, patrullojnë policë të më shumë shteteve evropiane. Tani Maqedonia e Veriut por edhe rajoni është shumë më i përgatitur se në vitin 2015 që të ballafaqohet me këtë problematik", deklaroi Kocev. Përndryshe, trendi i përpjekjeve ilegale të migrimit është në rritje, por autoritetet thonë se edhe numri i migrantëve, të cilët janë penguar që ilegalisht të kalojnë kufirin nga Maqedonia e Veriut drejt Evropës është i madh dhe tregues i përforcimit të kontrollit kufitar.

"Trendi i përpjekjeve ilegale të migrantëve është rritur, por në vitin 2018, kemi penguar dhe ndaluar të kalojnë kufirin ilegalisht mbi 16900 migrantë. Kjo flet për një trend në rritje, por edhe se kemi një mbrojtje të mirë të kufirit maqedono-grek", theksoi ministri Spasovski. Ai potencoi se rruga ilegale që shfrytëzonin migrantët nëpërmjet Maqedonisë së Veriut, në Serbi, drejt vendeve evropiane nuk funksionon më.

TURQIA I KËRKON MAQEDONISË 15 TURQ

Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Oliver Spasovski, ka deklaruar se situata në Veriun e Kosovës, nuk mund të ketë pasoja për rajonin. "Për momentin, nuk ka shqetësim i cili mund ta rrezikoi sigurinë e gjithë rajonit, veçanërisht për shkak të zhvillimeve që ndodhin në veriun e Kosovës. Pres që nëpërmjet dialogut të tejkalohen këto mospajtime të cilat janë të njohura midis Kosovës dhe Serbisë", deklaroi Spasovski. Ndërsa, i pyetur për kërkesën e zyrtarëve turk që të depërtojë nga vendi personat, të cilët autoritetet turke i kanë në listën e anëtarëve të organizatës FETO, Spasovski tha se për ekstradimin është kompetent Ministria e Drejtësisë, por se nga informacionet që ka ai, dy persona nga lista e 15 të kërkuarve, nuk janë më në territorin e Maqedonisë. "Procedurat që kanë të bëjnë me ekstradimin e anëtarëve të organizatës FETO të cilët gjenden në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i udhëheq Ministria e Drejtësisë. Informacionet e mija flasin se bëhet fjalë për 15 persona, nga të cilët dy vetëmse janë në territorin e Maqedonisë së Veriut", tha Spasovski.

PËRFUNDOJNË ADN ANALIZAT E TË VDEKURVE NË FATKEQËSINË E AEROPLANIT

Kanë përfunduar analizat e ADN-së të Institutit për mjekësi gjyqësore dhe për momentin dakordohet transporti i katër shtetasve bullgar, të cilët pardje i humbën jetët në fatkeqësinë e aeroplanit që ndodhi në "Solunska Glava", ka informuar ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. "Hetimin e zbaton Komisioni i pavarur për fatkeqësi të aeroplanëve dhe incidenteve serioze dhe të gjitha rekomandimet i japin ato, edhe në lidhje me marrjen e mbetjeve të aeroplanit. MPB është e gatshme edhe në këto kushte atë ta nxjerrë, megjithatë presim urdhër nga ky institucion", deklaroi Spasovski. Kryetari i Komitetit për hetime të fatkeqësive të aviacionit dhe incidenteve serioze - KHFAIS, Zoran Ilievski, mbrëmë ka informuar se mbetjet e aeroplanit do të merren menjëherë sapo ta lejojnë atë kushtet e motit, ndërsa nëse ka nevojë për ekspertizë të fluturakes, tha se atë do ta tregojë hetimi. Është formuar Komision për hulumtime të fatkeqësive në të cilën përveç përfaqësuesve të KHFAIS do të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm nga fusha e aviacionit civil. Në ekipin hetues për rrëzimin e "aeroplanit" do të përfshihen edhe dy hulumtues bullgar.

Edhe pesë të vdekur nga gripi, gjithsej 28 viktima

Shkup, 5 prill - Gjatë javës së kaluar, janë regjistruar pesë raste të vdekjes të shkaktuara nga gripi, prej të cilave tek dy persona është konfirmuar sëmundje e mëparshme kronike. Pesë pacientët që kanë ndërruar jetë nga gripi janë nga Shkupi, Delçeva, Kriva Pallanka, Ohri dhe Tetova, në moshë prej 39-75 vjeçare, njoftoi Instituti i Shëndetit Publik. Tek tre prej viktimave është izoluar virusi i gripit A(H1pdm) virusi i gripit, ndërsa tek një i tipit A. Numri i përgjithshëm i rasteve të vdekjes nga gripi gjatë sezonit 2018/2019 deri tani është 28. Gjatë javës së 13-të të vitit 2019 (25.03 - 31. 03.2019), janë raportuar 478 raste me sëmundje të ngjashme me gripin, që është për 51 për qind më pak në krahasim me javën paraprake. Në krahasim me javën e 13-të të sezonit të kaluar numri i personave me grip është rritur për 23,8 për qind.

Përpjekje e përbashkët kundër ndryshimeve klimatike

Shkup, 5 prill - Shtetet e Ballkanit Perëndimor dje në Tiranë biseduan për prioritetet kombëtare për aksion klimatik dhe do të bashkohen t'i definojnë mundësitë e miratimit të aksioneve të përbashkëta në këtë plan. Nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) thonë se ndryshimet klimatike bëhen çështje e sigurisë kombëtare dhe ekzistencës për shumë shtete. Ata ndikojnë në prodhimin e ushqimit dhe shkaktojnë dëme të konsiderueshme dhe humbje të prodhimeve bujqësore, mbikëqyrjen e bagëtisë, peshkimit dhe pylltarisë.

Qëllimi i konferencës dyditore, thonë në FAO është të tubojë në një vend përfaqësuesit e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë që të bisedojnë për prioritetet kombëtare dhe mundësitë e miratimit të planit të përbashkët mbi aksionin klimatik. "Ndjenjë e fuqishme publike për qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor dhe klimës paraqitet në gjitha pjesët e botës, por shpërndarja e mbështetjes financiare është jo e barabartë, ndërsa vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nevojë të rritjes së resurseve financiare që të mund të përballen me sfidat klimatike", ka thënë Vlladimir Rahmanin, ndihmësdrejtor i përgjithshëm i FAO-s dhe përfaqësues rajonal i FAO-s për Evropë dhe Azi Qendrore.

Shtetet e Ballkanit Perëndimor janë angazhuar të sigurojnë implementim efektiv të Marrëveshjes së Parisit dhe Agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm, ndërsa qasja në resurset financiare të masave urgjente për zbutje dhe adaptim në ndryshimet klimatike është me rëndësi të madhe, thonë nga FAO.

KEQMENAXHIMI ME INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

MUNGON BESIMI TE SHËNDETËSIA PUBLIKE

Shumica pacientëve mendojnë se përkushtimi dhe profesionalizmi i mjekëve në klinikat private është në nivel më të lakmueshëm, ndërkaq të dhënat nga Instituti i Shëndetit Publik thonë se njerëzit çdo ditë dhe më shumë kanë besim te duart e mjekëve nga spitalet private

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 5 prill - Çdo ditë e më shumë qytetarët nuk kanë besim tek institucionet shëndetësore shtetërore. Qytetarëve iu duhet të paguajnë për ilaçe që nuk i gjejnë nëpër spitale apo në listat e barnave të rimbursueshme. Mungesa e medikamenteve, vijon të mbetet problem i pazgjidhur, mosinvestimi në pajisje shëndetësore dhe shërbimi pa standard, janë të tjerë faktorë që e bëjnë sistemin shëndetësor shtetëror të pabesueshëm për qytetarët. Në pjesët rurale në gjithë vendin ballafaqohen me mungesa të mëdha, si të stafit të mjekëve, po ashtu edhe të infermierëve, por edhe me mungesë barnash e kushtesh të nevojshme për punë.

Pacientët ka vite që ballafaqohen me mungesë trajtimi adekuat në institucionet publike shëndetësore dhe për rrjedhojë ata orientohen tek institucionet private. Keqmenaxhimi i institucioneve shëndetësore publike nga ana e kuadrit joprofesional ka çuar deri në degradimin e këtyre institucioneve, ku edhe është humb besimi i qytetarëve.

"Shëndetësia ka dështuar veçmas në pjesën perëndimore të vendit, për shkak të keq menaxhimit me institucionet dhe me resurset njerëzore. Pra, duhet të merret seriozisht institucioni publik, edhe nëse zhvillohet mjekësia private. Mjekësia publike mbetet si ofruese e shërbimeve për një numër më të madh të personave në republikën tonë", thotë për gazetën KOHA, stomatologu Krenar Papraniku. Sipas tij, në institucionet shëndetësore publike, duhet të vendoset personel adekuat, ku edhe duhet të bëhet një revizion i shërbimeve publike.

Shumica pacientëve mendojnë se përkushtimi dhe profesionalizmi i mjekëve në klinikat private është në nivel më të lakmueshëm, ndërkaq të dhënat nga Instituti i Shëndetit Publik thonë se njerëzit çdo ditë dhe më shumë kanë besim te duart e mjekëve nga spitalet private. Sipas një studimi rezulton se rreth 1,9,000,000 njerëz kanë mundësinë të zgjedhin nëse ata do të shkojnë në një institucion shëndetësor publik ose të paguajnë për trajtim në disa nga spitalet e mëdha private. 600,000 prej tyre mendojnë se do të marrin një shërbim më të mirë në shëndetësinë private, ku edhe vendosin të shpenzojnë para më shumë për veten e tyre.

"Në Republikën e Maqedonisë Veriore, sipas OJQ ESE, 35% e popullsisë shpenzon para nga xhepi i tyre", thotë Shaban Memeti, drejtor i Institutit të Shëndetit Publik. Shëndetësia publike vuan nga mungesa e shumë faktorëve, duke filluar nga infrastruktura e deri te kuadri. Për ta ilustruar këtë gjendje mjafton e dhëna se për 100,000 banorë ka vetëm 250 mjekë.

ZJARRET NË POLLOG PASOJË E FAKTORIT NJERI

MBI 220 ZJARRE PËR VETËM TRE MUAJ

Kreu i zjarrfikësve të Tetovës ka përmendur edhe nevojën që të përmirësohen kushtet e zjarrfikësve, ndërsa nënvizoi se duhet të shtohen kapacitet e Njësisë së zjarrfikësve të Tetovës, sepse në numër janë të paktë për të mbuluar një territor kaq të madh

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 5 prill - Për tre muaj, në rajonin e Tetovës së bashku me komunat rurale janë regjistruar 223 zjarre. Kjo është për 90 zjarre më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kështu ka thënë Uka Aliti, udhëheqës i Njësisë Kundër Zjarrit në Tetovë, ndërsa ka shtuar se zjarret kanë ndodhur në vende të hapura kryesisht me pyje edhe atë në territorin e Komunës së Tetovës, Zhelinës dhe Bërvenicës.

"Në Njësinë kundër zjarrit në Tetovë që nga janari i vitit 2019 kemi regjistruar 223 intervenime të cilat intervenime me sukses i kemi kryer. Potencoj që çdokund kemi pasur sukses dhe kemi qenë efikas në shuarjen e këtyre zjarreve, mirëpo në krahasim me vitin 2018, na brengos fakti se shifrat e intervenimeve këtë vit janë në rritje shumë të madhe. Faktikisht, në tremujorin e parë që kemi bërë krahasim me të njëjtën periudhën të vitit të kaluar, kemi diku 90 e më shumë intervenime, që të gjitha intervenime në sipërfaqe të hapura, ku shumica prej këtyre zjarreve që janë paraqit dhe ne kemi intervenuar me shumë sukses kanë qenë në pyje. Ku mund të cekë fshatin Sallareve ku i tërë mali i fshatit Sallarevë dhe Llukovicë u dogj, pastaj Merovë dhe Kapaçdoll, ku poashtu është djegur mali, Veshallë Brodec ku poashtu janë djegur pyje... Dua të them këtu se të gjitha këto janë shkaktuar nga dora e ndonjë piromani, sepse temperaturat nuk kanë qenë të larta që zjarret të shpërthejnë vetë", tha Aliti.

Nga Njësia e zjarrfikësve pajtohen me zyrtarët e lartë të shtetit të cilët thonë se zjarret janë të qëllimshme. "Shumë e vërtetë është se duke i parë dhe duke qenë prezent, të gjitha këto zjarre të cilat kanë ndodhur në këtë periudhë kohore kanë qenë të qëllimshme, por ka pasur zjarre të cilat janë shkaktuar edhe nga pakujdesia e bujqve, të cilët në këtë periudhë bëjnë pastrimin e fushave dhe duke ndezur grumbullimin e mbeturinave që të pastrojnë fushat e tyre, mirëpo gabimi i tyre është se i lënë pa kontroll dhe ai zjarr pastaj edhe zgjerohet", deklaroi ai.

Aliti edhe njëherë ka apeluar që qytetarët të jenë të kujdesshëm me zjarret, kurse nga ana e tjetër, ka falënderuar banorët e fshatrave përreth zona të zjarrit që kanë ndihmuar sidomos në Sallerevë, por edhe policinë dhe komunat që kanë vënë në shërbim të gjitha kapacitetet e tyre. Njëherësh, Uka ka apeluar për përmirësimin e kushteve të zjarrfikësve, ndërsa nënvizoi se duhet të shtohen kapacitet e Njësisë së zjarrfikësve të Tetovës, sepse në numër janë të paktë për të mbuluar një territor kaq të madh.

Shkarkohen shtatë drejtorë të shkollave në Gostivar

Gostivar, 5 prill - Marrja e kompetencave të kryetarit Arben Taravari në fushën e arsimit nuk do të ketë befasi përderisa atë - ministri i Arsimit e bën për të tretën herë, tha dje në pres konferencë Aslian Snopçe përgjegjëse për arsimin në komunën e Gostivarit. Sipas asaj, në tre ditët e fundit janë ndërruar gjithsej shtatë prej 16 drejtorëve prej institucioneve arsimore në komunë. Snopçe këtë gjest e vlerësoi si skandaloz, ndërsa motivi është revanshizëm politik.

"Pas marrjes së dytë të kompetencave nga ana e ministrit për Arsim, në pjesën e emërimit dhe shkarkimit të drejtorëve, këto ditë vijonte vazhdimi i këtij vendimi politik. Paramendoni, në mes të fushatës parazgjedhore ministri lejon në mënyrë luksoze të shkarkojë drejtorë të emëruar nga ana e kryetarit dhe në vend të tyre i emëron drejtorët e vjetër partiakë", tha Aslijan Snopçe udhëheqëse e sektorit për arsim në komunën e Gostivarit. Ajo i bëri rekomandim ministrit resor të merret me sigurimin e mësimit dhe me përmirësimin e librave në gjuhën shqipe, me zbulimin e skandaleve në diplomat universitare dhe me rritjen e fondeve investuese në hulumtimet, e jo vetëm me Gostivarin.

"Ne jemi të bindur se pas shtatë muajsh, përsëri do të ketë investim 'kapital' nga ana e ministrisë së tij. Ai investim kapital do të jetë marrje e tretë e kompetencave të kryetarit të Gostivarit. Thuajse, se ai nuk di diçka tjetër të bëjë, megjithatë, nuk do ta ketë atë mundësi, për shkak se së shpejti situata do të ndryshohet dhe në Gostivar do të vijnë kohëra të reja", theksoi Snopçe. Kryetari Taravari, që është nga radhët e Aleancës së Shqiptarëve të Ziadin Selës, nga marrja e funksionit u ballafaqua me marrjen e kompetencave në pjesën e emërimit dhe shkarkimit të drejtorëve dy herë. Ai para një kohe të caktuar emëroi drejtorë të rinj, ndërsa para disa ditësh ministri filloi me shkarkimin e tyre.

Koncepti Shoqëri vs Republikë

Nga
Dr.Arben TARAVARI

Ka nisur fushata presidenciale, si në çdo fushatë politike çdo gjë është shumë dramatike, ankthioze dhe deri diku tërheqëse njësoj si një ndeshje futbolli me përmasat e një finaleje të kampionatit botëror.

Nuk e ekzagjeroj aspak kur metaforizoj me futbollin, pasi ne ballkanasit jemi tifozë në politikë, kemi një qasje romantike ndaj ligjit dhe aleatëve të tij, madje nëse ligji nuk na pëlqen e injorojmë haptazi, ky fenomen mund të përkufizohet si "romantizëm ligjor ballkanik". Një nga aspektet më interesante të këtij fillim fushate është thirrja me të cilën kandidati për President që propozon BDI-ja i drejtohet popullit. Ai bën thirrje për një shoqëri të bashkuar, duke e çuar në kasap praninë shumë shekullore të etnive që formojnë dhe banojnë këtë shtet, e duke na trumbetuar vetëm në një gjuhë, vetëm në një kryeetni, dhe etnia e zgjedhur ku BDI-ja dhe Pendarovski propozojnë të konvertohemi është ajo maqedonase.

Ashtu si shkarazi kandidati i BDI-së, z.Pendarovski përmend se rrugën për në NATO dhe BE duhet t'a bëjmë "Së bashku", nën emrin e Maqedonisë së Veriut. Profesori maqedonas që BD na udhëzon t'a votojmë si President, na fton që t'i besojmë konceptit me kontekst të fortë nacionalist si është "Një Shoqëri për të Gjithë"...këtë apel e bën në gjuhën maqedonase, nën flamurin maqedonas, duke harruar ditën për diell realitetin që e mban në këmbë këtë shtet. Maqedonia e Veriut është një shtet multi-etnik, e mbi të gjitha shqiptarët, që BDI-ja i quan 20%, janë faktorë në ekzistencën e brishtë të këtij shteti. Me formulën e vjetër aq sa padrejtësia dhe shovinizmi disa shekullor ndaj shqiptarëve, pra me thirrjen që të injorojmë diversitetin etnik që ka ky vend, Pendarovski i BDI-së na zeron, na kthen nga 20% në 0%.

Ku është e parë e dëgjuar që në emër të përparimit të mohohen dhe shuhen kombe?! Ky kandidat edhe pse e njeh nga afër sensibilitetin e lartë që ka trajtimi i çështjes multietnike në një vend që nuk ka as 20 vjet që ishte në luftë, del dhe haptazi fut konceptin: Poshtë kombet! Rroftë Maqedonia e Veriut! Lufta e cila u bë nga udhëheqësi tashmë i partisë që e kandidon, synonte dikur që shqiptarët të njiheshin si të barabartë, kurse sot që në vend të pushkës mbajnë pena, dalin dhe bëjnë fushatë anti-shqiptare! Kush mund t'a imagjinonte një ndryshim kaq drastik në konceptet e z.Ahmeti dhe partisë së tij?!

Në 2001-in drejtonte pushkën kundër maqedonasve e sot nxjerr si kandidat për President pikërisht një maqedonas, e për më tepër që mohon etnitë, kombet të cilët formojnë Maqedoninë e Veriut. Këto shkrirje në një emër të përbashkët janë të njohura si asimilim i mirëfilltë i kombeve dhe traditave të tyre. Si duket plani për të na asgjësuar qenka i mirëmenduar dhe i paska rrënjët shumë më të thella se ç'supozon truri ynë. Në fillim u përcaktuam jo si shqiptarë por si "20%-a", kurse tash as si të tillë.

Tash na mungon një ligj ku të na hiqet dhe e drejta e votës dhe të bëhemi njësoj si skllevërit e kohës antike, që mund t'i shisje, blije apo vrisje kur të doje dhe në de facto jemi, por si duket BDI-ja kërkon që skllavërimi i shqiptarëve të bëhet zyrtar. E lodhur nga ecejaket e shpeshta nga baza poshtë në kupolën lart, e lodhur me ndërhyrje, me mitmarrje, me shantazhe, dhe sidomos e frikësuar deri në palcë nga kërcënimi i rënies nga pushteti, kjo parti "finoke" kërkon që shqiptarët t'i asimiloj, shkrij, asgjësoj ose sllavizoj, ashtu dhe turqit, bullgarët, romët, vllehët, torbeshët, egjiptianët e çdo etni që jeton në Maqedoni. BDI-ja dhe kandidati i saj z.Pendarovski luajnë modernizmash ndërkohë që dihet qartë se koncepti "një shoqëri për të gjithë" është i dështuar pasi është provuar se ishte pikërisht kjo moto që njësoi gjuhën nëpër shkolla, duke bërë një nga krimet më të mëdha ndaj shqiptarëve, si ishte mohimi i gjuhës amtare!

Ndërkohë që z.Blerim Reka, kandidati që e mbështet populli dhe opozita, nuk kërkon të shpikë rrotën, po kërkon të sjellë atë që është shumë e vonuar në vendin tonë: REPUBLIKËN! Koncept i cili është elaboruar para erës sonë ose si do të shpreheshin latinët: Ante Christum natum! Mirëpo Republika e Rekës që garanton të Ligj për të Gjithë, Drejtësi, Barazi dhe respekt të njëjtë për çdo etni, çuditërisht nuk ka mundur të krijohet nga asnjë president deri tash, duke bërë të njëjtën gafë të rëndë politike: injoruar multietnicitetin e Maqedonisë së Veriut! BDI-ja na propozon rrezikun e regjimeve të shkuara se kështu ja kërkon halli, ajo kërkon që idealistët, ata që kanë mbetur ende e që nuk largohen prej këtu, na quan 20%, tash na bën të verbër me dorë duke vazhduar me misionin e saj eleminiues, na thotë se kandidati i tyre që flet një gjuhë të vetme (maqedonisht) do votuar se do të punojë që të gjithë të kenë të drejta të barabarta si qytetarë të Maqedonisë së Veriut, me fjalë të tjera, sipas BDI-së tash ka ardhur epoka e ndërrimit të emrit nga shqiptarë në qytetarë...gjithnjë sipas z.Pendarovski dhe partisë së tij BDI, nëse shkojmë në NATO, e nëse na pyesin nga jemi, atëherë përgjigjja do të jetë kështu: Jovani do thotë jam maqedonas, kurse Genti do thotë jam qytetar...dhe nëse Genti thotë që është shqiptar fis e farefis, askush nuk do ta besojë De Jure që nuk jeton në Shqipëri, pasi tashmë në Maqedoninë e Veriut sipas BDI-së dhe z.Pendarovski nuk ka shumë etni, por ka vetëm Shoqëri!

Sipas ofertës BDI-LSDM-Pendarovski i bie që me 21 mars të shkojmë të heqim dorë nga kombësia jonë! Zoti mos e dhëntë!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

E lodhur nga ecejaket e shpeshta nga baza poshtë në kupolën lart, e lodhur me ndërhyrje, me mitmarrje, me shantazhe, dhe sidomos e frikësuar deri në palcë nga kërcënimi i rënies nga pushteti, kjo parti "finoke" kërkon që shqiptarët t'i asimiloj, shkrij, asgjësoj ose sllavizoj, ashtu dhe turqit, bullgarët, romët, vllehët, torbeshët, egjiptianët e çdo etni që jeton në Maqedoni

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premte, 5 prill 2019 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Gara për të "shtrënguar daullen", pa "tradhti"

Nga
Daut DAUTI

Disa qarqe ose individë të cilën në zemër e kanë shqiptarinë, e kanë kuptuar shumë seriozisht garën presidenciale. Siç i ka hije kauzës kombëtare, japin apele e bëjnë gjyqe publike se po u votua kandidati maqedonas(mendohet në njërin nga dy sish), do të jetë tradhti. Dhe "tradhtia" u adresohet partive shqiptare që e kanë mbështetur kandidatin e koalicionit. Sikundër që, me të njëjtën logjikë, patriotizmi kësaj radhe shprehet duke apeluar që të votohet kandidati shqiptar, i përkrahur nga dy partitë shqiptare, Aleanca dhe Besa. Besoj se nuk ka shqiptar i cili mund ta vente në dyshim kandidaturën dinjitoze të profesor Blerim Rekës, duke pasur parasysh biografinë e tij: ish-gazetar dhe redaktor i Rilindjes dhe ish-ambasador, e sot profesor universitar me shumë vepra e punime shkencore. Emër për çdo respekt.

1. PARTITË SHQIPTARE, NJË QËLLIM ME DY STRATEGJI

Çështja për t'u diskutuar është a mund të gjykojmë me gjuhën e fundit të shekullit 19-të ose gjysmës së parë të shekullit 20-të tash pas tri dekada pluralizëm e demokraci, ku e drejta e organizimit, deklarimit, mendimit dhe përcaktimit është e shenjtë? Prandaj mendoj se ka nevojë të sqarohen disa gjëra për ta shikuar më me sy realistë.

E para, nuk ka nevojë të luhet "kukamsheftas" dhe të shtiremi se përnjëmend mund ta fitojnë shqiptarët postin e kryetarit jashtë tavolinës së marrëveshjeve. Sidomos jo pa mbështetje të maqedonasve. E shumta që mund të bëjë një kandidat shqiptar, po të ishte me përkrahje të të gjitha subjekteve shqiptare, është që "të kualifikohet" në raundin e dytë, por me kusht që njëri nga kandidatët maqedonas "ta shkelë" kandidatin tjetër me dallim të madh. Jo vetëm kaq, por duhet të plotësohet edhe një kusht tjetër, që kandidati fitues të mos marrë më shumë se gjysmën e votuesve të listës së përgjithshme zgjedhore e të bëhet kryetar që në rundin e parë.

Shihni, pra, se sa larg është mundësia për kandidatin shqiptar. Kjo nuk duhet ta inkurajojë prof. Blerim Rekën ta zhvillojë garën ashtu se e ka menduar shtabi i tij zgjedhor, por nuk duhet t'i gjykojmë të tjerët që mund të rreshtohen ndryshe, sepse pas këtyre disa dekadave, është më demode të flasim për tradhti.

E dyta, meqë situata objektive është kështu, atëherë mbetet që shqiptarët ta luajnë rolin e tyre në zgjedhjen e një kandidati më të pranueshëm. Kjo realizohet në disa

Në këto zgjedhje presidenciale a mund të gjykojmë me gjuhën e fundit të shekullit 19-të ose gjysmës së parë të shekullit 20-të, pas tri dekadash pluralizëm e demokraci, ku e drejta e organizimit, deklarimit, mendimit dhe përcaktimit është e shenjtë?

mënyra: nëpërmjet mbështetjes së hapur (siç e bëjnë kësaj radhe partitë shqiptare të koalicionit qeveritar), në mënyrë të fshehtë (shumë shpesh në të kaluarën) dhe nëpërmjet apelit të kandidatëve shqiptarë për të votuar ndonjërin nga kandidatët e kualifikuar në raundin e dytë. Në këtë kontekst është e rëndësishme edhe gara e prof. Rekës, jo më shumë për të, sa për partitë që e përkrahin.

Partitë shqiptare janë ndarë në dy grupe, që mëtojnë të arrijnë qëllimet e tyre me dy strategji të ndryshme. Dhe me dy "tajming"-e që ndërmjet kanë dy javë dallim. Supozojmë se qëllimi programatik është avancimi ose forcimi i statusit të shqiptarëve(ai me të cilin janë gojën plot) dhe forcimi i pozitës së tyre si subjekte politike. Kur je në pushtet ke mundësi marrëveshjeje për çështje që duhet zgjidhur, kur je në opozitë mund t'i japësh kosës më gjerë. Në kontekst të zgjedhjeve presidenciale, këto dy pozicione ndonjëherë mund të afrohen për shkak të konfiguracioneve politike. Më saktë, edhe partitë që janë në koalicion qeveritar, edhe partitë që janë në opozitë, mund të takohen për të realizuar secila palë qëllimin e vet.

Në zgjedhjet e deritashme presidenciale përherë ka pasur në garë më shumë kandidatë maqedonas dhe më shumë shqiptarë. Kandidatët e partive shqiptare kanë bërë fushatë sikur përnjëmend do të zgjidheshin, por prapavija ka qenë që të sigurojnë një pozitë të favorshme negociuese për raundin e dytë kur kandidatëve maqedonas u nevojiteshin votat shqiptare. Rregulli ka qenë i skematizuar: partitë që kanë qenë në koalicion, e kanë ndihmuar njëra tjetrën: PPD-ja Gligorovin, PDSH-ja ka ndihmuar Boris Trajkovskin, BDI-ja Cërvenkovskin(kurse në zgjedhje e kaluara presidenciale, bojkoti i BDI-së ndikoi në mënyrë indirekte, zgjedhja të bëhet në kuadër të trupit votues maqedonas, i cili aso kohe ishte në favor të Gjorge Ivanovit).

Duhet thënë se nuk ka kurrfarë tradhtie kombëtare në atë që partitë shqiptare që sot janë në koalicion me LSDM-në, të kenë arritur marrëveshje për përkrahjen e kandidatit Stevo Pendarovski. Në vend se ta bënin në raundin e dytë, e bëjnë që në të parin, hapur. Marrëveshja përveç aspektit të korrektësisë midis partnerëve të koalicionit, ka dhe efektin e vet praktik, sepse nuk humbet kohë, por bëhet përpjekje që të sigurohet fitorja që në raundin e parë. Partitë shqiptare sigurisht se këtë përkrahje nuk e kanë dhënë sa për sy e faqe, por në kuadër të një bashkëpunimi me interes të ndërsjellë. Në rastin konkret, pas këtij koalicioni janë disa arritje të cilat janë për çdo respekt: marrëveshja e Prespës(ndryshimet kushtetuese), ligji për përdorimin e gjuhëve(përkrahur edhe nga partitë shqiptare në opozitë), ftesa për NATO...

Gara e kandidati shqiptar, e supozuar që do të përfundojë me numër respektabil votash, do të vijë në të njëjtën pozitë si ajo e BDI-së, PDSH-së dhe Alternativës. Pra, çka do të bëjë me votat e fituara në raundin e dytë. A do të japë apel që të shkojnë njërit apo kandidatit tjetër maqedonas? Dhe me çfarë kushtesh? Cilit prej tyre? Fjala pazar politik nuk duhet të merret në kuptim pezhorativ, sepse në politikë çdo marrëveshje ka ndonjë farë pazari në mes, ku duhet të nxirret ndonjë përfitim. Më e mira do të ishte të jetë një përfitim nga qëllime e deklaruara të partive, por nuk përjashtohen edhe përfitime më "pragmatike". Çështja tjetër, që është reale, është se kush do të bëjë pazarin, kandidati, apo partitë që e kanë përkrahur atë dhe çka mund të përfitojnë në këmbim të përkrahjes. Nuk po e diskutoj aspak se me cilin kandidat mund të merren vesh. Sepse, siç shkruajti këto ditë një autor, nëse ato vota nuk orientohen drejtë, mund të humben ose të shkojnë në adresë të gabuar. Kuptohet, nuk e besoj se partitë shqiptare mund të merren publikisht me kandidaten që ka orientim skeptik ndaj proceseve euroatlantike, ndërkaq poashtu nuk e besoj se fshehurazi mund të bëjnë ndonjë marrëveshje për të përkrahur të njëjtën. Thënë troç, nëse partitë në pushtet e kanë definuar qëllimin që tash me përkrahjen kandidatit të LSDM-së, partitë opozitare këtë do ta definojnë në rundin e dytë. I bie që "tradhtia" e tyre duke përkrahur njërin kandidat maqedonas do të vijë vetëm dy javë pas partive shqiptare në pushtet. Ku dallojnë pra?

Të dy grupacionet politike, duan të shtrëngojnë daullen, siç thuhet në Dërven, për të fituar diçka më shumë, edhe pse në këtë moment nuk ka ndonjë çështje kruciale të hapur për t'u zgjidhur, prandaj dhe çdo përfitim mund të jetë i një natyre tjetër.

2. KËTO ZGJEDHJE (NUK) JAPIN LEGJITIMITET...

Flasim me një mik këto ditë dhe ai është shumë i sigurt kur thotë se gara presidenciale është edhe përcaktuese për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Aty ai e sheh rreshtimin Aleancës për Shqiptarët dhe Lëvizjes Besa. Duke mbështetur kandidatin e pavarur, prof.Blerim Rekën, ato duan të tregojnë forcën politike brenda kampit shqiptar. Por, unë jam më se i sigurt në të kundërtën dhe këtë i thashë pakashumë argumentet si vijon.

Së pari, përvoja e kaluar ka treguar se jo përherë kandidati shqiptar që ka fituar më shumë vota, ka treguar forcën e partisë përkatëse. Në një nga ato zgjedhje pat fituar Imer Selmani, si kandidat i partisë së sapoformuar, Demokracia e Re, i cili fitoi dyfishin e votave të kandidatit të BDI-së, por në zgjedhjet parlamentare dhe lokale raporti ka qenë krejt i kundërt. Për më tepër, Demokracia e Re vetëm përkohësisht e tregoi forcën kur arriti të barazohet me ish-partinë e tij në zgjedhjet lokale, por, gjithë kjo ndodhi sipas titullit të romani të një autori shqiptar("Ajo buzëqeshi vetëm një verë"). Sepse, siç e dimë, shumë shpejt, gjithë çka përfitoi, i humbi dhe sot nuk ekziston më Demokraci e Re.

Nëse Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja arrijnë një sukses në këto zgjedhje, prapë ai rezultat nuk mund të jetë indikator i forcës së tyre, sepse të mos harrojmë se pas një kandidati të pavarur(Prof.Blerim Reka), mund të votojnë edhe shumë qytetarë që nuk janë votues të tyre. Prandaj, nga këto zgjedhje para së gjithash duhet të shihet disponimi i përgjithshëm qytetar në orientimet gjeostrategjike të vendit dhe sa i aprovojnë politikat e deritashme të pushtetit të ri, duke pasur parasysh disa vendime me peshë të madhe historike.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)



Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

REKA PËR REPUBLIKËN
BLERIM REKA PËR PRESIDENT
VOTO
1
blerimreka.org
#EuReka

KOHA e lirë 125

shtojcë enigmatike e fundjavës

FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT: 3. Zmadhoj; 5. Ik; 7. Kryeqyteti i Francës; 9. Atdheu i Odisesë; 10. Kryej një veprim; 12. Të përndjekur politik; 13. Pjesa e dytë e stomakut të kafshëve ripërtypëse, aliver; 15. Mal në Greqi; **16. Emri i politikanes shqiptare në foto;** 18. Vijë uji, brazdë; 20. Fija që lidh palcën e kurrizit me organet; 23. Gjendja e lirë e motorit; 24. Specialist për energjinë atomike; 26. Qytet në Gjermani; 28. Pjatë e thellë ; 29. Ish portieri suedez, Matias; 30. Ushqimi që merr me vete bariu për të ngrënë gjatë ditës; 31. Vepër e Shekspirit; 33. Punonjës me përgjegjësi i administratës; 41. Instrument muzikor, bori (sh.) 42. Gojëtar; 43. Përemër pronor; 44. Dijetari i madh islam, Didat; 47. Pjesë e dyerve; 48. Kitaristi i grupit "Oasis", Galager (shq.); 49. Institucionet shtetërore.

VERTIKALISHT: 1. Mjet kuzhine; 2. Trofeu i luftëtarëve të indianëve (lëkura e flokëve); 3. Lloj druri; 4. Këngëtarja amerikane, Tarner; 5. Rritja e numrit, shumim; 6. Njësia e vjetër e peshës; 8. Fund, mbarim (bised.); 9. I errët; 11. Një anë e botës; 12. Sinjal në raste shqetësimi; 14. Kodi dydimensional; 15. Arenë për manifestime muzikore dhe poetike te grekët dhe romakët e lashtë; 17. Vëmendje e kujdes i veçantë për për diçka; 18. Një stinë viti; 19. Perëndia greke e luftës; 21. Mote; 22. Emri i Njutnit; 23. Inicialet e aktorit kosovar, Daka; 24. Zakoni, tradita; 25. Simboli i Tenesinit; 27. Që bëhet në mënyrë të natyrshme e vetvetiu; 30. I prish mendjen dikujt, hutoj; 32. Inicialet e këngëtarit Labi; 33. Floriri; **34. Mbiemri i politikanes shqiptare në foto;** 35. Sipër, përmbi; 36. Inicialet e autorit dhe karikaturistit tonë, Arsllani; 37. Simboli i argjendit; 38. Në këtë kohë, tani; 39. Aktori anglez, Piter; 40. Pjesëmarrës në film; 45. Humnera, gremina; 46. Aktori shkodran, Kadria.

Kakuro

5x5 dhe 6x6

Kakuroja është kombinim i fjalëkryqit dhe Sudokut. Në vend të shkronjave shënohen numra edhe atë prej 1 deri 9. Numrat nuk duhet të përsëriten as horizontalisht e as vertikalisht. Numrat brenda fushave duhet t'i japin shumat, të cilat janë dhënë në skajet e fushave që duhet të plotësohen.





mini FJALËKRYQI

Plotësojeni fjalëkryqin sipas figurave të dhëna!



KOHA e lirë
për më të rinjtë

Labirinti

Cila është rruga e drejtë deri te caku?



7 dallimet

Gjejini dallimet te këto dy fotografi!



Fshehësira

Ku fshehen figurat e dhëna?

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "*është më i madh se*".



KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.



ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!



NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.

	1 2	1	1 1	1	2 1
1 1					
2					
1 1					
2					
1 1					

mini SKANDI me anagrame

Anagramet e mëposhtme japin dy vepra të autores sonë në foto.

Anagrami 1
(Vëllim poetik)

SY SI DETI JON

Anagrami 2
(Vëllim poetik)

S'U LA URTI E ËNDA!

MENSUR MAMUTI	AUTORJA JONË NË FOTO	BESËLIDHËS	ANAGRAMI 2	AKTORI
KËNGË E SAJMON-GARFANKELIT, "EL CONDOR..."				
JO NË KËMBË				
"NËNA E ZOTRAVE" TE EGJIPTASIT E LASHTË				
AKTORI FRËNG, ZHAK / ATDHETARI YNË, ZEKA				

KOHA E LIRË	NJËSIA PËR REZISTENCË ELEKTRIKE	ANAGRAMI 1	PA DOBI, KOT / VEND NË KENTAKI, SHBA					
SHPËRBLIMI MË I MADH I FILMIT						EDMOND TUPJA / ABDULLAH ZENELI		
BOTËRORI								
KOHA E LIRË	VESHJE PËR DUAR / LËNDË MBËSHTJELLËSE PREJ CELULOZE							TË QENËT E VIRGJËR
PËRDORIM I NJË PJESE TË TEKSTIT TË NJË AUTORI / TRASTA E MADHE PREJ PËLHURE						NUHI VINCA / JAKUP KRASNIQI		
TH				MARRËVESHJE (BISED.) / USHTRIA KOMBËTARE				
51 ROMAK			RRIP DIMIASH / KOMPANI LOJËRASH KOMPJUTERIKE					
BEJZBOLLISTI JAPONEZ, JUJA						ADEM GJINISHI / PJESË E MOLEKULËS		
GRYKË / SHKRIMTARI DHE FOTOGRAFI SHQIPTAR, DODA				QYTET NË DALMACI (PASHQ.) / KOCKË LOJËRASH FATI				
B							RUMANIA / LEC BUSHATI	
VEND NË SKOCI (NERABUSI) / VJERSHË LIRIKE MADHËSHTORE (SH. PASHQ.)								
D								

Sudoku

i lehtë

8			3					
3			9		2		4	
	1			8	7			
		4		9		2		
	5		2		3		8	
	7			4			9	
			4	2			1	
	2		5		8			4
					6			8

mesatar

6		7	5	8	2		4	1
			9		4			
		8						
2	5			9			1	3
4			2		6			8
9	8			5			6	7
						8		
			6		7			
7	1		8	2	5	6		9

i vështirë

	1	3		6				
	2			7				
9		7	4		2			
		4	9			2		
6	3						8	1
		9			6	5		
			5		3	6		8
				8			7	3
				9		1		

		7	4		6	8		
4			9	3	8			1
2	9		3		1		6	8
	3						4	
6	8		5		7		9	3
9			6	5	3			7
		3	7		2	9		

8			6	3	9			4
		4				2		
	7						3	
4				8				3
5			3		4			6
7				9				5
	4						8	
		7				1		
1			9	2	5			7

	1		2					
			4			7		
				3		1		9
9				6	8			
5								2
	7		1		5			8
	5			9		2		
			8					7
		6	5		3			

INCIDENT NË MES KOSOVËS DHE SERBISË NË TIRANË

Konferenca mbi "Klimën në Ballkanin Perëndimor", që pritej të zhvillohej të premten në orën 10:00 në Tiranë, është anuluar për shkak të incidenti mes delegacionit serb dhe atij kosovar

Mësohet se delegacioni serb nuk ka pranuar të rrijë bashkë me delegacionin kosovar, të dy të ftuar si pjesë e kësaj konference të rëndësishme. Kosova nuk ka pranuar të përfaqësohet nën logon UNMIK, me pretendimin se është shtet i pavarur. Nga ana tjetër delegacioni serb nuk e ka pranuar pjesëmarrjen e Kosovës në këtë Konference, e për këtë arsye janë larguar, duke mos dashur lejimin e Kosovës si anëtare me të drejta të plota në OKB.

Delegacioni serb nuk ka pranuar të ulen në të njëjtën tryezë me homologët nga Kosova.

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, u shpreh se Kosova nuk mund të përfaqësohet më nën siglën e UNMIK.

"Ajo që ndodhi lidhet me rregullat strikte të përcaktuara të Kombeve të Bashkuara që kërkojnë që Kosova dhe më tutje të jetë e përfaqësuar nën siglën e UNMIK-ut ose të përfaqësohet nga persona të qeverisë së Kosovës por të shoqëruar nga zyrtarë të UNMIK-ut që për Kosovën është e papranueshme dhe nuk do të ndodhë më asnjëherë. Konferenca tani do të zhvillohet në nivel teknik.Megjithatë ne e shfrytëzuam këtë mundësi për të takuar të gjithë donatorët.Askush nuk duhet të ëndërrojë që do të ketë një mjedis të pastër, të mirë dhe të pranuEshëm në Ballkanin Perëndimor nëse ka ëndrra të tilla që një vend mund të përjashtohet nga projektet dhe tryezat e përbashkëta",ka thënë Matoshi.

Ndërsa Ministri i Mjedisit dhe Turizmit, Blendi Klosi, tha se ky ishte një aktivitet i organizuar nga Kombet e Bashkuara dhe Shqipëria si vend pritës kishte ftuar dhe Kosovën.

"Është një aktivitet i organizuar nga Kombet e Bashkuara, nën rregullat e Kombeve të Bashkuara. Si vend mikpritës i aktivitetit unë ftova Ministrin Matoshi.Rregullat e Kombeve të Bashkuara janë të përcaktuara dhe jashtë kompetencave tona si Ministra.Sot patëm pozitivitet real pasi Kombet e Bashkuara dhe të gjithë donatorët e pranuan Kosovën si pjesë e kësaj tryeze. Ne bëmë ftesën sepse për ne ishte e palogjikshme të organizohej një aktivitet për rajonin dhe Kosova të mos ishte pjesë e këtij diskutimi.Patëm një dakordësi me Kombet e Bashkuara dhe Serbinë lidhur me zhvillimin e aktivitetit, prezencës së Kosovës si i ftuar special. Nuk u pranua nga organizatorët prezenca me të drejta të plota e Kosovës si folës dhe si prezencë në tavolinë e Kombeve të Bashkuara", ka thënë Klosi.

Mariya Gabriel: Hapi tjetër për Roaming, të ulim tarifat BE-Ballkan

Komisionerja për Ekonominë dhe Shoqërinë Digjitale, Mariya Gabriel ishte të enjten, në Beograd për të marrë pjesë në e Samitin e dytë Dixhital të Ballkanit Perëndimor. Komisionerja mbajti një fjalim kryesor në sesionin e hapjes dhe mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes Rajonal Roaming, e cila ishte pjesë e Axhendës Digjitale për Ballkanin Perëndimor, të paraqitur vitin e kaluar në Maj, e cila filloi zyrtarisht në qershor 2018. Komisionerja Gabriel tha pas nënshkrimit në ceremoni: "Jam shumë e kënaqur të shoh që Partnerët e Ballkanit Perëndimor kanë arritur një marrëveshje për të ulur kostot e roamingut në rajon. Ne kemi mbështetur plotësisht këtë proces të lehtësuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. Kjo nuk është e jona, është marrëveshja e partnerëve të Ballkanit Perëndimor, i cili do të sjellë përfitime të konsiderueshme për qytetarët dhe bizneset në rajon. Ky nënshkrim është një demonstrim solid i vullnetit të fortë politik drejt arritjes së një integrimi të fuqishëm digjital rajonal. Kjo do të sjellë Partnerët e Ballkanit Perëndimor një hap më afër angazhimit të zgjeruar me BE-në". Samiti Digjital i Ballkanit Perëndimor i këtij viti i kushtohet aftësive digjitale, rrjeteve, lidhjes, besimit dhe sigurisë të ekonomisë digjitale, si dhe shoqërisë. Mariya Gabriel në intervistën dhënë për gazetën "Shekulli", është entuziaste për arritjen e saj dhe të Komisionit Evropian. "Gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor do të përfitojnë nga ulja e tarifave të shërbimit roaming, duke filluar nga 1 korriku i këtij viti, ndërkohë tarifat do të hiqen tërësisht mes Shqipërisë dhe Kosovës. Marrëveshja u nënshkrua gjatë Samitit të dytë Dixhital, që po zhvillon punimet në Beograd. Tarifa e romingut nënkupton telekomunikimin dhe shërbimin që qytetarët e një shteti përdorin në një shtet tjetër. Këto tarifa, zakonisht janë dyfish më të larta sesa ato që përdoren për telekomunikimin brenda një shteti", ka nënvizuar Mariya Gabriel.

Për vrasësit të gazetarit Quruvlija 100 vjet burgim

Këshilli gjyqësor i Gjykatës Speciale ka dënuar katër ish pjesëtarë të Sigurimit Shtetëror të Serbisë me gjithsej 100 vjet burgim për vrasje të gazetarit dhe kryeredaktorit të gazetës serbe "Dnevni Telegraf" Sllavko Quruvija. Gjykata ka konstatuar se kryerësi i drejtpërdrejtë i vrasjes është personi NN.

Për vrasje të gazetarit Quruvija 100 vjet burgim për pjesëtarët e Sigurimit të Serbisë

Ish shefi i Sigurimit të Shtetit të Serbisë Radomir Markoviq është dënuar në 30 vjet burgim për nxitje të vrasjes së rëndë. Ish shefi i Qendrës beogradase të SSH Milan Radonjiq gjithashtu është dënuar me 30 vjet burim për vrasje të rëndë në bashkëkryerje. Ish pjesëtarët e SSH Ratko Romiq dhe Miroslav Kurak janë dënuar me nga 20 vjet burgim për vrasje të rëndë në bashkëkryerje. Kurak është në arrati dhe aktgjykimi i është shqiptuar në mungesë.

Në arsyetim të aktgjykimit pretendohet se Radomir Markoviq e ka planifikuar vrasjen në detaje dhe ia ka përcjellur Radonjiqit i cili i ka angazhuar Kurakun dhe Romiqin për kryerje të vrasjes.

Kolegji nuk e ka pranuar propozimin e mbrojtjes së të dënuarve që në gjykatë të ftohen si dëshmitarë kyçë politikanët të cilët kanë qenë në krye të shtetit në kohën kur ka ndodhur krimi, në mes tyre është dhe ministri i atëhershëm për informim Aleksandar Vuçiq.

Të përkujtojmë, Qurivija është vrarë më 11 prill 1999, sipas urdhrit nga strukturat më të larta shtetërore. Si motiv pretendohet dëshira që të kufizohet liria e medieve dhe të ruhet fuqia dhe pushteti, përfaqësuesit e të cilës Qurivija i ka kritikuar publikisht. Ai ishte kryeredaktor i gazetës serbe "Dnevni Telegraf" i cili në mënyrë të vazhdueshme e kritikonte pushtetin e atëhershëm të cilin e përbënin PSP ku kryetar ishte krimineli Sllobodan Millosheviq ndërsa zëdhënës ministri i tanishëm serb Ivica Daçiq, si dhe PRS, kryetari i të cilës ishte krimineli Vojisllav Sheshel ndërsa nënkryetar, presidenti i tanishëm serb Aleksandar Vuçiq./Insajderi.com.

Strasburgu, Shqipëria kryeson listën me 13.4 milionë euro dëmshpërblime

Shqipëria është shteti ndaj të cilit Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka dhënë vlerën më të lartë të vendimeve në formë dëmshpërblimi gjatë vitit të kaluar. Sipas raportit vjetor të vetë Gjykatës së Strasburgut dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, rezulton se, vendimet kundër shtetit shqiptar gjatë 2018-ës nga gjykata kanë qenë në masën 13.4 milionë, si asnjë shtet tjetër i kontinentit të vjetër përgjatë 1 viti. Pas Shqipërisë ndjek Rusia, me 13.1 milionë dhe Italia me 9.7 milionë.

Në total vlera e vendimeve kundër vendeve anëtare të gjykatës, pra që kanë ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, fiksohet në 68 milionë euro përgjatë 2018-ës. Shqipëria përfaqëson 1/5 e totalit. E ndërkohë që në 2018 shifra fiksohet në 13.4 milionë euro, në 2017 ishte vetëm 123 mijë euro. Në raport vihet re gjithashtu se shteti shqiptar është ndër më problematikët në Europë sa i përket respektimit të afateve të pagesave.

Në rastin e Shqipërisë thuajse të gjitha çështjet i referohen atyre që kanë të bëjnë me pronën, pra kompensime, shpronësime, apo shtetëzime. Në kapitullin dedikuar Shqipërisë, thuhet se është bërë progres në këtë drejtim që prej vitit 2015, me ndërtimin e një mekanizmi që i mbulon nga buxheti i shtetit pretendimet për kompensim. Në total, këto pretendime kapin shifrën e 1.2 miliardë eurove, ose rreth 9% e Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendit. /scan

KËRCËNIMI RUS, NATO ME FLOTË NË DETIN E ZI

Të enjten ishte samiti i dytë i NATO-s, për sa i përket 70-vjetorit të saj si aleancë. Gjatë fjalës së tij para të pranishmëve, Jens Stoltenberg vuri në dukje rolin që do të ketë NATO në të ardhmen. Përplasje të reja janë në horizont. Rusia po shikohet si kërcënim

Mbledhja e Ministrave të Jashtëm të vendeve të NATO-s në Washington, ka nxjerrë në pah edhe kërcënimet e reja për perëndimin dhe sigurinë. Ai që e ka vënë në dukje këtë gjë, ka qenë Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës së NATO-s, Jens Stoltenberg. Prania e shtuar Ruse në Detin e Zi dhe braktisja e Traktatit të Parandalimit të Armëve bërthamore (INF)nga ana e Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë, riformësojnë skenarin për një përplasje të të dy blloqeve në Detin e Zi. Në këtë pjesë të këtij rajoni, Rusia ka një prezencë të konsiderueshme ushtarake dhe ekonomike. Është dalja më e afërt e Rusisë në ujërat detare. Mund të themi që është një rajon për të cilën Federata Ruse interesohet shumë dhe që sipas studiuesve të gjeopolitikës, është brenda sferës së influencës ruse. Por ky kërcënim nga ana e Rusisë, ka marrë një përgjigje të prerë nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Në fjalimin e djeshëm para të pranishmëve, Stoltenberg theksoi rendësinë e këtij rajoni. Për të zbutur reaksionin rus ndaj shtrirjes së influencës perëndimore në Lindje, Stoltenberg theksoi se NATO nuk do të ndërtojë baza ushtarake në Evropën Lindore. Kujtojmë se këto baza ushtarake, në Poloni dhe Republikën Çeke, kanë qenë edhe shkak për fillimin e luftës mes Rusisë dhe Gjeorgjisë, në gusht të vitit 2008.

FJALIMI I PLOTË I STOLTENBERG:

"Shtatë dekada më parë, në këtë ditë, në këtë qytet u themelua Aleanca jonë. Ministrat e jashtëm nga dymbëdhjetë vende në Evropë dhe Amerikë Veriore nënshkruan Traktatin e Uashingtonit. Këto kombe premtuan të qëndrojnë së bashku dhe të mbrojnë njëri-tjetrin. Kjo premtim na ka dhënë shtatëdhjetë vjet paqe, prosperitet dhe siguri. Këtë mëngjes Ministrat e Jashtëm të Aleatëve iu drejtuan shkeljeve të vazhdueshme të Rusisë të Traktatit të INF-it. Duke vendosur batalione të shumta të raketave SSC-8, Rusia e ka bërë botën një vend më të rrezikshëm. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tjerë janë përpjekur të angazhohen me Rusinë për këtë sistem raketash për disa vite. Ne të gjithë pajtohemi që Rusia vazhdon të jetë në kundërshtim me traktatin. Dhe sot, ne të gjithë i kërkojmë përsëri Rusisë që të kthehet në pajtueshmëri të plotë dhe të verifikueshme me Traktatin e INF-it. Por koha po mbaron. Pra, NATO po përgatitet për një botë pa Traktatin e INF-IT. Sot, kemi diskutuar rrugën përpara. Dhe cilat masa të mundshme mund të ndërmarrim, nëse Rusia nuk do të kthehet në pajtim me traktatin. Ne nuk do të pasqyrojmë atë që po bën Rusia. Ne do të matemi dhe koordinohemi. Ne nuk kemi ndërmend të vendosim raketa bërthamore në terrenin e Evropës. Në të njëjtën kohë, NATO do të vazhdojë të jetë një pengesë dhe një mbrojtje e efektshme. Dhe të gjithë aleatët janë fuqimisht të përkushtuar ndaj kontrollit të armëve dhe mospërhapjes. Shkelja e vazhdueshme e Rusisë e Traktatit të INF është një model i sjelljes destabilizuese. Rusia përdorte forcën për të aneksuar ilegalisht Krimenë nga Ukraina. Dhe vazhdon ndërtimet ushtarake të saj në të gjithë rajonin. Ne i bëjmë thirrje Rusisë që të lirojë marinarët dhe anijet e Ukrainës që u kapën vitin e kaluar pranë Detit të Azov. Ne diskutuam se çfarë mund të bëjmë më shumë për të rritur sigurinë tonë në rajonin e Detit të Zi. Ne kemi rënë dakord për një paketë masash për të përmirësuar vetëdijen tonë të situatës. Dhe për të rritur mbështetjen tonë për Gjeorgjinë dhe Ukrainën. Në fusha të tilla si trajnimi i forcave detare dhe rojeve bregdetare. Vizitat dhe ushtrimet në port. Ndarjen e informacionit. Kjo do të mbështetet në bashkëpunimin tonë tashmë të ngushtë. Tani për tani, një nga grupet detare të NATO-s është në patrullim në Detin e Zi. Dhe sot, po stërvitet me anijet ukrainase dhe gjeorgjiane. Pra, ne do të ruajmë fokusin tonë dhe praninë tonë në këtë rajon jetik".

REAGIMI I MINISTRISË SË JASHTME RUSE

Maria Zakharova, zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme ruse, të enjten ka uruar NATO-n për "paqen e brendshme dhe për më pak nervozizën", ndërsa aleanca shënon 70 vjet që nga krijimi i saj. "Në ditëlindjen e 70-të të NATO-s, ne do të dëshironim që aleanca të këtë një paqe të brendshme dhe të jenë më pak nervoze. Shpresojmë që të shmanget duke u fokusuar në obsesionet dhe fobitë", ka cituar në Twitter, Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme, Maria Zakarova. Ministrat e jashtëm nga 29 vende të NATO-s po takohen në Uashington këtë javë për të festuar përvjetorin e aleancës. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, në fjalimin e hapjes të enjten, përmendi "agresionin rus" si një kërcënim në rritje. Rusia ka akuzuar në mënyrë të përsëritur bllokun e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara për zgjerimin e paligjshëm në lindje në Evropë, në kundërshtim me premtimet e tij. NATO po ndërton ushtrinë e saj në krahun lindor të Rusisë, duke shtuar trupat në Estoni, Letoni, Lituani dhe Poloni në vitin 2017, ndërsa anijet luftarake të SHBA kanë qenë në mënyrë rutinore duke qenë të pranishme në portat e Detit të Zi.

Rusët shumë të varfër për të blerë këpucë

Sekretari rus i shtypit në Kremlin ka thënë se nuk mund ta kuptojë anketën që tregon se rusët nuk mund të përballojnë blerjen e këpucëve të reja.

Dmitry Peskov komentoi një raport të agjencisë shtetërore të statistikave Rosstat, transmeton portali arbresh.info.

Hulumtimi gjeti se një e treta e familjeve të anketuara nuk mund të përballonin dy palë këpucë për person, në vit. Të dhënat gjithashtu zbuluan se 80% e familjeve ruse e kanë të vështirë të mbijetojnë. Anketa në fakt tregon një përmirësim të lehtë në disa fusha të financave familjare. Por shifrat e saj të zymta – dhe zhurmat e Z. Peskov – kanë kapur vëmendjen, duke sugjeruar që zyrtarët nuk janë në kontakt me realitetin e përditshëm.

I pyetur për të komentuar për gjetjet, zëdhënësi i presidentit Vladimir Putin psherëtiu thellë para se të thoshte se Kremlini "luftoi" për të kuptuar të dhënat. "Pse këpucë? Pse një e treta? Nga ku janë këto shifra?" Z. Peskov kërkoi, duke shtuar se ai do të ishte "mirënjohës" për një shpjegim nga Rosstat. Detajet janë qartësisht të disponueshme online, së bashku me anketën e "vëzhgimit të standardeve të jetesës" të agjencisë, që kryhet çdo dy vjet. Shifrat e fundit janë nga një sondazh i kryer në shtator 2018, i cili mbulon rreth 60,000 shtëpi nëpër Federatën Ruse.

Ndër të gjeturat e saj, studimi zbulon se afër gjysma e të gjitha familjeve nuk mund të shkojnë për një pushim vjetor një jave, madje duke qëndruar me miqtë apo familjen. Rreth 10% e të pyeturve nuk mund të kishin mundësi të hanin mish ose peshk tri herë në javë dhe 12.6% e shtëpive kishin ose një tualet komunal ose kishin një tualet jashtë.

Terroristi i Zelandës së Re do t'i nënshtrohet testit të shëndetit mendor

Personi i cili akuzohet për vrasjen e 50 personave në sulmin terroristë në dy xhamitë në Christchurch të Zelandës së Re, është urdhëruar që ti nënshtrohet testit të shëndetit mendor.Ai do të vlerësohet nga ekspertët për të vendosur nëse ishte i aftë për t'u gjykuar ose i çmendur, tha gjyqtari i gjykatës së lartë, Cameron Mander, raporton "Tch".

I dyshuari përballet me 50 akuza për vrasje dhe 39 akuza për tentative vrasje.

Australiani Brenton Tarrant, 28 vjeç, u shfaq në sallën e gjyqit, e mbushur me të afërmit e disa prej viktimave, nëpërmjet lidhjes me video nga burgu.

Ashpërsohet lufta e fjalëve SHBA-Turqi



Një luftë fjalësh midis Shteteve të Bashkuara dhe Turqisë është intensifikuar për shkak të Sirisë.

Ankaraja kritikoi fuqishëm deklaratat e Departamentit amerikan të Shtetit në lidhje me një takim të sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, me ministrin e Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu, në margjina të ceremonive për 70-vjetorin e themelimit të NATO-s, në Uashington.

Departamenti i Shtetit tha se Pompeo e paralajmëroi Turqinë për "pasoja potencialisht shkatërruese" nëse Ankaraja nis ofensivë në Siri dhe se ai kërkoi "zgjidhjen e shpejtë" të rasteve ligjore që përfshijnë "qytetarët amerikanë të burgosur padrejtësisht" në Turqi.

Ministria e Jashtme e Turqisë tha se ky njoftim nuk pasqyron përmbajtjen e takimit dhe se përfshin çështje që nuk u diskutuan.

Cavusoglu tha se është "vërtet i befasuar" me interpertimin që i ka bërë SHBA-ja takimit të tij me Pompeon.

"Unë isha atje ... një gjuhë e tillë kurrë nuk u përdor. Për Sirinë veçanërisht, ata kurrë nuk përmendën gjëra të tilla në lidhje me veprimet e njëanshme të Turqisë", u tha Cavusoglu gazetarëve.

I pyetur për vërejtjet e Turqisë, Pompeo tha se qëndron prapa interpretimit që i ka bërë Departamenti amerikan i Shtetit takimit të tij me Cavusoglun.

Shtetet e Bashkuara dhe Turqia mbështesin grupe të ndryshme rebele në luftën e Sirisë

Një kroat në Tiranë

Alen Brlek (Zagreb, 1988) është autori i ftuar në Rezidencën letrare "Tirana in Between", organizuar nga POETEKA, si pjesë e READING BALKANS, bashkëmbështetur nga Programi "Europa Krijuese" i Bashkimit Europian.
Alen Brlek i përket gjeneratës më të re të poetëve kroatë. Në vitin 2013 ai u vlerësua me çmimim më të rëndësishëm për librin më të mirë në dorëshkrim (Metakmorfoze – titulli simptomatik për të gjithë veprën e autorit) i cili u botua në vitin 2014 nga "Algoritam." Poezia e Alen Brlek mbetet thellësisht brenda kërkimit dhe misterit të gjuhës, duke eksploruar shtigjet e saj të fshehura dhe duke provokuar qarqe të shkurtra si dhe duke vënë në pikëpyetje logjikën e saj. Libri i tij i dytë, "Pratišina", u botua në Serbi nga "Kontrast", 2017.
Në bashkëpunim me poetin Darko Šeparović dhe muzikantin Emil Andreis Alen Brlek po eksploron hapësirat mes poezisë dhe muzikës në kuadër të projektit "Zaron". Poezitë e tij janë botuar në mjaft revista letrare dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Shpesh ato poezi shfaqen në skenë në sfondin e një hip-hopi si fjalë muzikore, që i drejtohen fillimisht audiencave jo poetike, në të cilat bashkohen teknikat e arteve të ndryshme.
Në një intervistë të botuar pas publikimit të vëllimit të dytë me poezi, Alen Brlek e përshkroi poetikën e tij me përgjigjen lakonike, por të qartë: "Punk nuk ka vdekur." Për poezitë e botuara në rrjetet sociale ai është përzgjedhur për çmimin "Post scriptum" 2017. *(G.Sh)*

HISTORIA E PIKTURAVE QË ERDHËN NË TIRANË ME KAMIONË NDIHMASH

Përveç njohjes me artin e prodhuar nga më shumë se 50 artistë në periudha të ndryshme kohore, këto ekspozita na prezantojnë dhe me situatën që po kalonin të dyja vendet, Kosova dhe Shqipëria në të njëjtin vit.

"Urimet më të mira për 1999", quhet ekspozita me koleksionin më të mirë të veprave të dhuruara nga artisti Jan Dibbets, hapur në Galerinë Kombëtare të Arteve. Artisti i njohur ia ka dhuruar Galerisë shqiptare këto vepra pikërisht në vitin 1999, dhe titulli simbolizon disi dhe kohën kur ky koleksion mbërriti për herë të parë në Shqipëri, ku çdo ekspozitë synonte të kontribuonte për ditë më të mira. Arnisa Zeqo kuratorja e kësaj ekspozite ka treguar ndër të tjera dhe aventurën e ardhjes së këtij koleksioni në Shqipëri.

"Pothuajse njëzet vite më parë – në vitin 1999 – veprat e ekspozuara sot këtu kanë udhëtuar drejt Tiranës nga bodrumi i Muzeut Stedeljik dhe nga studio e artistit Jan Dibbets në Amsterdam, me shumë gjasë, me kamionë ndihmash. Qytetin ato e gjetën në një psikogjeografi e një peizazh akustik shumë specifik. Ndërkohë që veprat po udhëtonin për në Tiranë, nga Kosova ishin nisur mbi gjysëm milionë refugjatë.

Tirana po mblidhte veten nga ngjarjet traumatike të viteve 1997-1998. Galeria Kombëtare e Arteve ka një histori të pasur të koleksionimit të veprave të artistëve vendas, shumë prej të cilëve kanë krijuar gjatë periudhës së Realizimit Socialist", tha Zeqo. Sipas saj, veprat e Koleksionit Jan Dibbets shkaktojnë ndjesi të kundërt me atë të koleksionit permanent, sepse vijnë nga situata krejt të ndryshme sociale e politike.

Pikëtakimi mes këtyre dy situatave të ndryshme të koleksionimit, hap një rrugë të trazuar. Si arrijnë veprat e artit dhe koleksionet e artistëve të krijojnë agjenci që trazojnë?". "Kjo ekspozitë do të shërbejë edhe për të prezantuar për publikun disiplina të tjera të artit, si ajo e performancës nëpërmjet një programi edukativ dhe publik që do të zhvillohet përgjatë muajve të hapjes së ekspozitës deri në përfundim të saj më 22 shtator 2019", tha Zeqo.

Drejtori i Galerisë, z. Erzen Shkololli ftoi publikun që të vizitojë ekspozitën e këtij koleksioni si dhe atë të artistit Sokol Beqiri "As Mik as Armik" e cila u hap një javë më parë në sallën e ekspozitave të përkohshme. Përveç njohjes me artin e prodhuar nga më shumë se 50 artistë në periudha të ndryshme kohore, këto ekspozita na prezantojnë dhe me situatën që po kalonin të dyja vendet, Kosova dhe Shqipëria në të njëjtin vit. *(G.Sh)*

Oskar Wilde, në skenën e Teatrit Eksperimental

Drama "Salome" nga Oskar Wilde do të vijë premiere në skenën e sallës Molierë në Teatrin Eksperimental në datat 13 -14 Prill ora 20:00. Nën regjinë e Carlo Sciccaluga, në role interpretojnë Ermira Hysaj, Alert Çeloaliaj, Ervin Bejleri, Yllka Mujo, Alesia Xhemalaj, Emiljano Bufazi, Ermir Hoxhaj, Ilia Kaçi, Ismail Shino, Kleivert Ibrahimllari, Marsel Greva dhe Urim Aliaj.
"Salomé" është tragjedi me një akt, shkruar nga Oskar Uajlld dhe bazohet lirisht mbi historinë biblike, ashtu siç është treguar në librat e Dhiatës së Vjetër, Marku 6:15-29 dhe Mateu 14:1-12, edhe pse karakteri i Salomesë nuk përmendet me emër në Bibël. Vepra vendoset gjatë periudhës biblike në Judé, një zonë historike, me shtrirje në Lindjen e Mesme, pranë së cilës sot ndodhen Palestina dhe Izraeli. Salomé është thjeshtra e mbretit Herod Antipas të Judesë.
Ai është bashkëshort i Herodias, e cila është e mallkuar nga një profet me emrin Jokanaan (i njohur në Bibël si Gjon Pagëzori). Ky thotë se martesa e Herodit është e paligjshme, sepse Herodias është vejusha e vëllait të Herodit. Në Bibël, Salomé e ndihmon të ëmën të marrë hak ndaj Gjon Pagëzorit, ndërsa në veprën e Uajlldit vendimet e Salomesë ndaj Jokanaanit vijnë si rezultat i dëshirës së saj për hakmarrje nga epshi.
Për tmerrin e mbretit dhe për gëzimin e së ëmës, Salomé kërkon kokën e Jokanaanit në një pjatë argjendi, si shpërblim për vallen e shtatë vellove, që ajo do të kërcejë para mbretit Herod. Për arsye se ligji britanik i kohës ndalonte shfaqjen publike të pjesëve teatrore, ku përshkruheshin personazhe nga Bibla, Uajlld e shkroi "Salomé"-në në frëngjisht në vitin 1891. Ajo u shfaq së pari si një pjesë teatrore në frëngjisht. Tre vjet më vonë u botua një version i saj në anglisht. Për publikun britanik u shfaq për herë të parë në vitin 1918, disa vjet pas vdekjes së Oskar Uajlldit.

Ibrahim Kadriu fiton "Pena e artë" në Suedi

Ditë më parë, në Suedi, në qytetin Boras,u mbajt Festivali Ndërkombëtar i Poezisë, i teti me radhë, "Sofra poetike Boras 2019", organizuar nga Qendra Kulturore Shqiptare e Borasit.

Ishte ky një event i rëndësishëm me pjesëmarrjen e shumë poetëve, me ç'rast u prezantua edhe "Antologjia poetike" e autorëve pjesëmarrës. Në këtë manifestim laureat i takimit ishte Ibrahim Kadriu, të cilit iu nda "Pena e artë" për gjashtëdhjetë vjetorin e krijimtarisë së pandërprerë letrare, transmeton Koha.net. Manifestimi letrar vazhdoi edhe në Nordshoping, ku u bë prezantimi i Ulmar Kvikut,

me rastin e botimit të librit të tij "Më shumë heroizma sesa grurë", që çmohet si kryevepër në mesin e veprave të tjera që ky autor (tash në moshën e shtyrë) ka botuar. Ulmar Kvik, siç dihet, për gjysmë shekulli ka qenë i lidhur shpirtërisht me popullin shqiptar.

Në kuadër të këtij manifestimi në Goteborg u organizua takimi me publik, ku u fol për zhvillimin e letërsisë shqipe pas tranzicionit, si në Shqipëri (foli Prof. dr. Zyhdi Dërvishi) dhe në Kosovë (foli Ibrahim Kadriu), ku edhe u përurua libri poetik i Ibrahim Kadriut, me titull "Udhëkryqet", përkthyer nga Hamit Gurguri dhe redaktuar nga poetja Anna Mattsson, e cila njëherësh është edhe anëtare e Bordit të PEN-it suedez. Para të pranishmëve, të cilët edhe bënë pyetje të shumta, Anna Mattsson i lexoi poezitë e Ibrahim Kadriut në gjuhën suedeze, ndërkaq autori i lexoi shqip.

LIGA E PARË - JAVA E 26 E PASUR ME PËRBALLJE DERBI

SHKËNDIJA PRET RENOVËN, SHKUPI TAKOHET ME RABOTNIÇKIN

"Një seri pozitive më katër fitore të njëpasnjëshme i hyjmë ndeshjes së radhës kundër Renovës të dielën në Tetovë në të cilën ambiciet tona mbeten të njëjta fitore dhe tre pikë të reja. Luajmë me një rival që po manifeston futboll të mirë, ku kanë patur edhe rezultate të mira në gjysëmsezonin pranveror dhe ne kemi respekt për ekipin e Renovës", deklaroi Qatip Osmani

Koha — Fisnik NUHIU

Shkup, 5 prill - E diela do të sjell në program ndeshjet e javës së 26 në Ligën e Parë futbollistike të Maqedonisë së Veriut. Kjo xhiro do të jetë e mbushur me përballaje derbi, dhe ndoshta do të jetë njëra nga javët më të nxehta për këtë sezon. Në qytetit do te luhet derbi i rivalëve mes Shkëndijës dhe Renova. Skuadra e Shkëndijës po vazhdon të ruaj kreun e tabelës dhe është duke hapëruar me hapa të sigurt drejt titullit të tretë në Ligën e Parë. Nga ana tjetër Renova, në gjysmësezonin pranveror është duke treguar mjaft ndeshje cilësore ku ka arritur dhe të ngjitet në vendin e katër në tabelën e klasifikimit. "Kuqezinjtë" në këtë përballje do të jenë ekip më cilësore por kjo pritet të dështmohet gjatë 90 minutave në terren. Trajneri, Qatip Osmani është optimist se nga kjo përballje do të dalin fitues, dhe se do të vazhdohet me serinë pozitive të rezultateve. "Një seri pozitive më katër fitore të njëpasnjëshme i hyjmë ndeshjes së radhës kundër Renovës të dielën në Tetovë në të cilën ambiciet tona mbeten të njëjta fitore dhe tre pikë të reja. Luajmë me një rival që po manifeston futboll të mirë, ku kanë patur edhe rezultate të mira në gjysëmsezonin pranveror dhe ne kemi respekt për ekipin e Renovës. Normal ne kemi ambiciet tona, besoj se jemi ekip më cilësor por këtë duhet ta dështojmë për 90 minuta në terren. Do të dalim me një vendosje adekuate që do të përputhet me kërkesat e rivalit dhe besoj që në fund do të marrim tre pikët", theksoi trajneri i Shkëndijës, Qatip Osmani. Nga ana tjetër edhe në stadiumin e Çairi do të kemi ndeshje derbi, ku vendasit FC Shkupi do të presin Rabotniçkin. Skuadra e trajnerit Umut Karan nuk din për fitore që katër ndeshje, dhe pikërisht presin që të dielën para tifozëve vendas të ndërpresin serinë negative të rezultateve. "E filluam shumë mirë gjysmë sezonin pranveror, por ja që tani më kemi pas vete katër disfata. Por ndeshja e radhës është e një rëndësie të veçantë për ne, që të rikthehemi tek suksesi. Dëshirojmë që të kemi një fillim të mbarë. Padyshim që jemi të motivuar për këtë përballje, kemi kualitet të mirë dhe ne kemi qëllimet tona deri në fund të sezonit. Besoj se do ta bëjmë atë që duhet bërë në këtë ndeshje", ka thënë sulmuesi i krahut nga Mali, Maharafa Tandina. Shkupi edhe në këtë ndeshje do të ketë një mungesë, pasi që sulmuesi Viktor Angelov kishte marrë një lëndim në përballjen me Renovën dhe paraqitja e tij është në dyshim. Ndeshje interesante do të luhet edhe në lagjen Maxhari të Shkupit, ku Vardari do të jetë nikoqire e Akademija Pandevit, të cilët këtë sezon kanë zhvilluar ndeshje shumë të mira dhe këtë e dështmon edhe pozita e tretë në tabelën e klasifikimit. Mysafirët janë vetëm 4 pikë nga Vardari dhe më një fitore eventuale të dielën do të zvogëlonin pikët në -1. Në takimet tjera Bellasica në shtëpi do të luaj me Sileksin ndeshje e cila për nikoqirët është shumë e rëndësishme, pasi me fitore do të arrin të kalonin Sileksin në tabelën e klasifikim të cilët për momentin radhitën të tetën në tabelë, vend që siguron ndeshjen e balotazhit. Makedonija GJ.P para tifozëve vendas do të jetë favorite ndaj Pobedës të cilët me shumë gjasa nga viti i ardhshëm do të jenë pjesë e Ligë së Dytë. Të gjitha përballjer luhen ditën e diel me fillim prej ora 15:30.

Azemi fiton medalje të artë në Bullgari

Shkup, 5 prill - Boksieri i Klubit të Boksit "Shkupi" dhe reprezentuesi i Maqedonisë së Veriut në boks, për junior dhe të rinj, Ardian Azemi, arkëtoi medaljen e artë në turneun ndërkombëtar të boksit "Emil Jeçev" në Bullgari. Boksieri shqiptarë në finale mundi boksierin nga Kazakistani, Roman Diar me 5-0, duke e hedhur dy herë në nokdaun, pas së cilës ishte e qartë se fitorja do të shkojë për boksierin nga Maqedonia e Veriut. Në rrugën deri te medalja e artë, Ardijan Azemi mundi reprezentuesit nga Kazakistani, Meriam Bolashak, si dhe reprezentuesin e nga Bullgaria, Martin Bebov.

Krasniqi mbron titullin ndaj gjermanit Hartel

Haxhi Krasniqi do të mundohet të mbrojë titullin e kampionit evropian më 11 maj në duel me boksierin gjerman, Stefan Hartel Haxhi Krasniqi e ka mësuar emrin e kundërshtarit të radhës. Boksieri kosovar do të rikthehet në ring më 11 maj të këtij viti, në meçin e parë për vitin 2019. Junikasi e mbylli vitin 2018 si kampion evropian dhe këtë vit do të mundohet ta mbrojë këtë titull dhe më pas ta synojë titullin e kampionit botëror, e cila është një ëndërr e tij e kamotshme. Boksieri me nënshtetësi gjermane ka njoftuar përmes rrjeteve sociale për meçin e radhës. "Robin Krasniqi më 11 maj do të ndeshet me gjermanin Stefan Hartel, i cili si kundërshtar ishte i papararë për

duelin e kaluar, por atëherë ishte tërhequr. Për Krasniqin është kjo mbrojtja e dytë e titullit të më të mirit të Evropës dhe dueli numër 55. Ky duel do të mbahet në 'Stadthalle' të qytetit gjerman, Magdeburg", ka njoftuar grupi zyrtar i boksierit kosovar në Facebook. Krasniqi i ka nisur përgatitjet intensive për këtë meç disa muaj më parë dhe është i gatshëm për ta mposhtur boksierin gjerman.

Një lojtar i rrallë si Miloti

Ndonëse ende në fazë të hershme të karrierës, Milot Rashica shpejt ka kaluar me suksese të gjithë lojtarët që prej futbollit kosovar kanë kaluar në nivel evropian. Me formën aktuale, ai po kalon edhe të gjithë lojtarët e përfaqësueses së Kosovës, të paktën nëse bëhet fjalë për paraqitjet e këtij edicioni. Dhe ngadalë po zë vend në mesin e futbollistëve më të mirë shqiptarë. Rashica së fundi është i pandalshëm në një skuadër që nuk di për humbje në vitin 2019 e që bën pjesë në një prej ligave më të forta evropiane. Në katër ndeshjet e fundit me Werder Bremenin, Rashica 22-vjeçar ka kontribuar me pesë gola e një asistim. I frymëzuar nga forma e lartë e Rashicës, por edhe lojtarëve të tjerë, Werderi të mërkurën mbrëma siguroi gjysmëfinalen e Kupës së Gjermanisë, ndërsa është ngritur në pozitën e gjashtë në Bundesligën e Gjermanisë. Kjo vlerësohet një ngritje e madhe për Werderin, por ngritja e Rashicës e kalon atë të skuadrës. Jo shumë kohë më parë ai nuk kishte besimin e plotë të trajnerit. Dhe tani trajneri ka fjalët më të mira të mundshme për të.

Xhaka i gatshëm për Evertonin

Granit Xhaka pritet të jetë në dispozicion të trajnerit Unai Emery për ndeshjen kundër Evertonit, të cilën Arsenali e luan këtë të diel, kanë njoftuar mediumet angleze të enjten. Xhaka javën e shkuar pësoi lëndim, derisa ishte tubuar me Përfaqësuesen e Zvicrës dhe i mungoi Arsenalit në duelin e fundit kundër Newcastlet, të cilin e fitoi ditë më parë me shifrat 2:0. Xhaka ka disa ditë që po punon me intensitet të lartë për të qenë i gatshëm për lojë pas lëndimit të ijeve. "Po punoj shumë për të qenë i gatshëm për këtë vikend që ta ndihmoj ekipin", ka thënë Xhaka. Mesfushori 26-vjeçar këtë edicion ka shënuar katër gola dhe ka asistuar tri herë në 32 ndeshje në të gjitha garat. Arsenali pas 31 ndeshjeve të zhvilluara në Premier League, zë vendin e katërt në tabelë me 63 pikë të grumbulluara. Pjesë e Arsenalit është edhe mbrojtësi shqiptar Shkodran Mustafi, por këtë sezon ai ka humbur vendin e titullarit.

NBA

ANTETOKOUNMPO FITON DUELIN ME EMBIID

Në "Fargo Center" të Philadelphias gjithçka mbeti e hapur deri në minutat e fundit, por pikërisht në momentin më vendimtar Bucks treguan se jo më kot përbëjnë skuadrën më të mirë të sezonit të rregullt, duke fituar 122-128

U zhvilluan vetëm tri ndeshje në NBA e sigurisht spektakli dhe emocionet mbizotëruan sidomos në përballjen mes Philadephia 76ers dhe Milwaukee Bucks, ku përballeshin forca e parë e Konferencës së Lindjes me të tretën, ndërsa sfida brenda sfidës ishte mes Joel Embiid dhe Gianis Antetokounmpo. Në "Fargo Center" të Philadelphias gjithçka mbeti e hapur deri në minutat e fundit, por pikërisht në momentin më vendimtar Bucks treguan se jo më kot përbëjnë skuadrën më të mirë të sezonit të rregullt, duke fituar 122-128. Plot 45 pikë, 6 asiste dhe 13 rikuperime ishin statistikat e Antetokounmpos, kandidatit kryesor për të fituar çmimin MVP të sezonit të rregullt, ndërsa Embiid iu afrua shumë, duke realizuar "triple-double": 34 pikë, 13 asiste dhe po 13 "rebound". Kontribut të rëndësishëm në suksesin e Bucks dhanë edhe Middleton dhe Hill, respektivisht me 22 dhe 20 pikë, ndërsa, përveç Embiid, në radhët e 76ers tregoi formë të mirë, pavarësisht humbjes, J.J. Redick me 29 pikë. Asnjë pengesë serioze për kampionët në fuqi të Golden State Warriors përballë Los Angeles Lakers. Në "Steples Center" dominuan kryesuesit e Perëndimit, duke fituar në fund me rezultatin 90-108. Skuadra e Steve Kerr krijoi një distancë të madhe që në periodën e parë me një rezultat të pjesshëm 12-39, për ta administruar me shumë lehtësi më pas këtë epërsi. DeMarcus Cousins e mbylli si më i miri i sfidës me "double-double", 21 pikë dhe 10 rikuperime. Në takimin e tretë dhe të fundit u përballën dy ekipe matematikisht jashtë zonës play off. Sacramento Kings iu imponuan 117-104 Cleveland Vacaliers, takim ku spikati me 23 pikë Buddy Hield, me Bogdan Bogdanovic që shtoi edhe 18 pikë të tjerë për Kings.

Arrestoh et babai i Messit

Babai i Lionel Messit, Jorge, është arrestuar pas një aksidenti në trafik me një biçikletar 24-vjeçar në Rosario të Argjentinës. Një biçikletar u dërgua në spital pasi mbeti pa vetëdije nga një aksident trafiku me babanë e Lionel Messit, Jorgen, i cili po e voziste një BMË në qytetin argjentinas, Rosario. I lënduari u dërgua menjëherë në spital me ambulancë, ndërsa Jorge u shoqërua deri në stacionin policor, ku u kontrolluan të gjitha dokumentet e tij. Ai besohet se i ishte nënshtruar edhe disa testeve për substanca të palejueshme. Aksidenti ndodhi rreth orës 20:00 dje. Dëshmitarët në këtë ngjarje kanë thënë se biçikletari kishte mbetur pa vetëdije. Megjithatë, lëndimet e tij nuk janë serioze. Ky incident nuk pritet të vazhdojë me proces gjyqësor dhe ende nuk dihet se cili nga të aksidentuarit ishte fajtor. As ylli i Barcelonës e as babai i tij nuk e kanë komentuar ende këtë incident. Në vitin 2016, Jorge ishte shpallur fajtor nga një gjykatë spanjolle për evazion fiskal, bashkë me djalin e tij. Dënimet e tyre me burg u zvogëluan në gjobitje.

Armiku i Rossit: Nëse vazhdon të garojë do të bëhemi shok skuadre



Gjatë një interviste të dhënë për të përditshmen spanjolle "Marca", piloti Marc Marquez ka folur për marrëdhënien e tij me italianin Valentino Rossi. Pyetja ndaj Marquez ishte provokuese: "A do të ndaje një ditë të njëjtin motor me Rossin?" Edhe përgjigjja e spanjollit ishte ironike: "Nëse vazhdon të pilotojë deri në moshën 50 vjeç një ditë mund të garojmë për një njëjtin motor". Pavarësisht kësaj, Marquez e vlerëson atë që Rossi po bën në pistë. "Është 40 vjeç, garon dhe duelon për fitore. Është jashtëzakonisht i motivuar dhe e habitshme mënyra se si përball çdo garë. në pistë mes nesh ka gjithnjë rivalitet, e rëndësishme është që të respektojmë njëri-tjetrin pas garës", u shpreh Marquez, që me Rossin nuk ka marrëdhënie të mirë. Duke folur për sezonin që sapo ka nisur në Moto GP, piloti spanjoll i Honda zbulon se cilët janë 2 rivalët e tij kryesorë. "Rossin e vendos mes rivalëve edhe pse shoh disi më mirë Dovizioso. Mendoj se këtë vit do të duelojmë të 3 për titull, ashtu si edhe vjet. Lorenzo? Ende nuk është ambientuar me motorin Honda edhe pse është shumë i talentuar. Tani për tani nuk më shqetëson për titullin", tha Marquez.

Publicitet

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
SHPALLJE
Projekt A - Leje e integruar ekologjike

Në përputhje me nenin 95 paragrafi 1 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16, 28/18 dhe 65/18), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar kërkesë nr.11-6867/1 nga data 10.08.2009 për marrjen e A-Lejes për harmonizim me planin operativ.
Dorëzuesi i kërkesës:
Shoqata aksionare "Oranzherii - Hamzali" Hamzali
Adresa: Fsh.Hamzali, Bosilovë
Koordinata e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:
N 41,48308 E 22,74002
Personi për kontakt:
1. Vase Mitev, Drejtor
e-mail: adhamzali@yahoo.com
Kategoria e instalacionit:
1.1 Instalacione me djegie, me hyrje nominale të nxehtësisë më të madhe se 50 MW.
6.4 (b) Punimi dhe përpunim të dedikuar për prodhimin e ushqimit prej:
- Lëndëve të para nga bimët, me kapacitet të prodhimit të materialeve të gatshme mbi 300 t/ditë (vlerë mesatare në bazë kuartale).

Kapaciteti i projektuar:
Kapaciteti i nxehmësit 51,2 MW
2.160.000,00 kg
Lloji i aktivitetit:
Prodhimi i avullit dhe ujit të ngrohtë
Prodhimi i kulturave bujqësore të hershme kopshtare
Drejtoria e Mjedisit Jetësor pranë MMJPH përgatiti
Projekt A - Leje të integruar ekologjike
Për: Shoqata aksionare "Oranzherii - Hamzali" Hamzali
Projekt Leja do jetë e shpallur në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moepp.gov.mk

Informacione në lidhje me Projekt Lejen A - të integruar ekologjike, të interesuarit do të mundet të marrin në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor (e-mail i.nikoloska@moepp.gov.mk

Të interesuarit, në afat prej 14 ditëve nga dita e shpalljes në mjetet e informimit, do të mundet t`i dërgojnë vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt Lejen, në formë të shkruar, deri te Ministria e Mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në këtë adresë: Sheshi Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup.

NJOFTIM
Fakulteti juridik **"JUSTINIAN I PARË"** në Shkup, njofton që **me datë 20.04.2019 (e shtune) në ora 11**, kandidati **M-r Marko Krtolica** do ta mbrojë disertacionin e doktoraturës me temë: **"Drejtësia tranzicionale dhe zbatimi i saj në ballafaqimin me të kaluarën komuniste në Evropë".**
Mbrojtja do të mbahet në sallën e takimeve të Fakultetit juridik "Justiniani i parë" - Shkup, Bul. "Goce Dellçev" 9b - Shkup (shkalla për NNS nën dekanatin)
Nga Fakulteti juridik
"JUSTINIANI I PARË" Shkup

Shitet shtëpi me 144 m2 me përdhesë dhe kat. Shtëpia ndodhet para xhamisë Sulltan Murat (Sahat Kulla). Çmimi sipas marrëveshjes.
Tel. 075/471-409

Shesim tokë ndërtimi - 9000m2
Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m2.
Tel. 071/372-215 & 078/243-583

BARCELONA DËSHIRON TA MBAJË MESSIN NË KLUB PËRGJITHMONË

"Do të donim që Messi ta rinovonë kontratën e tij, kjo është ideja jonë. Ai është i ri, ju mund ta shihni këtë në paraqitjet e tij, dhe edhe i ka dy vjet në kontratën e tij. Ai është gjithmonë duke u përmirësuar. Besoj se ka shumë vite të tjera karrierë para vetës dhe në ditët e radhës, ne do të ulemi me të në mënyrë që të jetë në Barcelonë edhe për shumë vite të tjera", ka deklaruar Bartomeu

Presidenti i Barcelonës, Josep Maria Bartomeu, ka bërë të ditur se dëshiron ta mbajë Lionel Messin të lidhur me klubin katalonas përgjithmonë dhe ai planifikon që së shpejti të ulet me argjentinasin për të diskutuar për rinovimin e kontratës. Messi nënshkroi kontratë të re me Barcelonën para dy vjetëve dhe kjo kontratë është e vlefshme deri në verën e vitit 2021, që do të thotë se Messi do të jetë lojtar i Barcelonës të paktën deri sa të bëhet 34-vjeçar. Argjentinasi nuk është duke e shfaqur asnjë shenjë që po shkon drejt fundit të karrierës. Ai i ka shënuar 42 gola dhe i ka bërë 21 asiste në 39 ndeshje këtë sezon. Bartomeu është duke menduar tashmë për kontratën e dhjetë e ndoshta edhe të fundit për Messin në Camp Nou. "Ne duam që ai ta ketë një karrierë shumë të gjatë në mënyrë që ta shijojmë atë sa më shumë. Lioneli ka arritur t'i thyejë të gjithë kufijtë. Të gjithë e adhurojnë atë dhe ai duartrokitet në stadiume edhe nga tifozët rivalë", është shprehur Bartomeu. "Do të donim ta rinovojmë kontratën e tij, kjo është ideja jonë. Ai është i ri, ju mund ta shihni këtë në paraqitjet e tij, dhe edhe i ka dy vjet në kontratën e tij. Ai është gjithmonë duke u përmirësuar. Besoj se ka shumë vite të tjera karrierë para vetës dhe në ditët e radhës, ne do të ulemi me të në mënyrë që të jetë në Barcelonë edhe për shumë vite të tjera". "Messi është njeri i vetëm një klubi. Kjo ka të bëjë me më shumë sesa vetëm çfarë ndodh në fushë – marrëdhënia e tij me Barcelonën do të zgjasë përgjithmonë. Unë e përmend rastin e Peles, i cili qëndroi gjithmonë në Santos. Ne duam që Messi të jetë gjithmonë në Barcelonë, si lojtar apo si i lidhur me klubin". Messi veçse është golashënuesi më i mirë në histori të klubit katalonas, me 594 gola të shënuara. Ai e ka kaluar Andres Iniestan për t'u bërë futbollisti i dytë me më së shumti paraqitje për Barcelonën (676). Vetëm Xavi Hernandez (767) ka më shumë se ai. Që kur Messi debutoi për Barcelonën, klubi ka shijuar më shumë suksese sesa kurdo tjetër në historinë e tyre. Ata i kanë fituar tetë nga 11 titujt e sezoneve të fundit të La ligës dhe katër nga pesë triumfet e tyre në Ligën e Kampionëve kanë ardhur me Messin në fushë.

Kërkesa marramendëse e Pogbës për drejtorët e Unitedit

Manchester Unitedi është duke luftuar kundër Real Madridit për t'i mbajtur shërbimet e Paul Pogbës në klub, mirëpo ky i fundit i ka disa kërkesa të mëdha për klubin anglez sa i përket pagës së tij. Paul Pogba shkaktoi një alarm të madh në Manchester United kur tha se transferimi në Real Madrid do të ishte ëndërr për të. Pas këtyre komenteve, shumë media raportuan se klubi madrilen dëshiron ta transferojë francezin gjatë verës. Zinedine Zidane madje tha fundjavën e kaluar se i pëlqen Pogba shumë. "Nëse kur të përfundojë përvoja e tij me Unitedin dhe ai dëshiron të vijë këtu, pse jo?" The Sun raporton se Pogba është i kënaqur që po i ofrohet mundësia për të qenë pjesë e Real Madridit, mirëpo është i gatshëm ta vazhdojë karrierën me "Djajtë e kuq" nëse ata ia ofrojnë pagën prej 580 mijë eurosh në javë. Kjo do të ishte një rritje dramatike prej pagës së tij aktuale, 350 mijë euro në javë. Për momentin lojtari më i paguar në klub është kiliani Alexis Sanchez, i cili paguhet rreth 500 mijë euro në javë, përkundër që nuk është titullar në skuadrën e Ole Gunnar Solskjaer. Pogba e kishte refuzuar një ofertë nga Real Madridi në vitin 2016, kur vendosi që të kthehet në Old Trafford nga Juventusi, për një shumë që atëherë e bëri francezin lojtarin më të shtrenjtë në botë, 105 milionë euro. Pogba i ka shënuar 11 gola dhe i ka asistuar nëntë të tjera në 29 paraqitjet e tij në këtë sezon të Premierligës me Manchester Unitedin, që është në pozitën e gjashtë me tri pikë më pak se Arsenali në vend të tretë.

Ronaldo, humb gjyqin me gazetën gjermane

Gazeta gjermane, Der Spiegel, ka bërë të ditur se e ka fituar procesin gjyqësor kundër Cristiano Ronaldos, pasi ky i fundit e kishte paditur gazetën për publikimin e disa dokumenteve që kishin të bëjnë me taksat e portugezit. Hakerët e "Football Leaks" i kishte siguruar një numër të madh të dokumenteve që e tronditen botën e futbollit. 60 gazetarë të Der Spiegel i kishin hetuar ato dokumente dhe në fund i kishin publikuar akuzat ndaj Cristiano Ronaldos për evazion fiskal.



Avokatët e Ronaldos e dërguan gazetën gjermane në gjykatë. Fillimisht, gjykata kishte vendosur që ta detyrojë Der Spiegelin t'i fshijë të gjitha artikujt për këtë çështje. Nëse vendimi nuk do të respektohej, gazeta do të gjobitej me 250 mijë euro. Gjatë procesit gjyqësor, avokatët e akuzuan gazetën gjermane që kishte përdorur dokumente të siguruara nga një mënyrë joligjore, pa e mohuar asnjëherë vërtetësinë e atyre dokumenteve. Der Spiegel i largoi ato artikuj nga versioni digjital, mirëpo e apeloi vendimin. Tani, dy vjet më vonë, superylli portugez e humbi këtë proces gjyqësor pasi që gjykata vendosi që gazeta gjermane kishte të drejtë t'i publikojë ato dokumente. Vitin e kaluar, Der Spiegel i publikoi edhe disa dokumente të tjera të "Football Leaks", ku Kathryn Mayorga e akuzon Ronaldon për përdhunim

Götze i "hap dyert" e Liverpoolit

Mario Götze duket sikur është vënë "në kërkim" të Liverpool-it. Mesfushori 26-vjeçar i Dortmundit dha një intervistë për gazetën "Bild" dhe foli në lidhje me momentin që po kalon, karrierën dhe të ardhmen e tij. Ai tha se mban kontakte të shpeshta me Jürgen Klopp. Trajneri aktual i "Reds" ishte ai, me të cilin ylli gjerman bëri debutimin në elitën e Bundesliga. "Unë jam gjithmonë në kërkim të sfidave të reja. Flas shpesh me trajnerin Klopp. Unë iu bashkova ekipit të parë të Dortmundit kur isha 17 vjeç. Klopp bëri gjithçka ishte e mundur për të më marrë dhe më rriti shumë si trajner. Kurrë nuk kemi ndalur së komunikuari me njëri-tjetrin", - thotë Gotze për tabolidin e njohur gjerman. Futbollisti pranon se në vitin 2016, kur u kthye në Dortmund dhe Klopp ishte në stolin e Liverpool, trajneri gjerman e dinte se ai donte të largohej nga Bayerni. Tani, lufta e Liverpool për t'u bërë kampion i Premier League është e ashpër me Manchester City e Pep Guardiolës, një tjetër trajner, me të cilin ai ka punuar. Gotze mundohet të japë vlerësimin e vet për të dy: "Ata janë të vështirë për t'u krahasuar, sepse ndjekin filozofi të ndryshme. Fakti është se të dy kanë shumë sukses, iu jam mirënjohës.

Jam me fat që kam punuar me dy trajnerë të tillë spektakolarë, i shoh ndeshjet e të dyja ekipeve të tyre, sa herë që mundem. Lufta për titullin në Premier League është shumë emocionuese".

REKA PËR REPUBLIKËN
BLERIM REKA PËR PRESIDENT
VOTO
1
blerimreka.org
#EuReka

DASHI 21. mars - 20. prill

Jeta juaj ne çift nuk do jete shume e mire gjate kësaj dite dhe ne disa momente mund te konfliktoheni ashpër me partnerin. Keni pak kohe qe nuk keni folur sinqerisht me njeri-tjetrin dhe keni mbajtur sekrete. Beqareve nuk do ju mungoje dëshira për te joshur, por ende nuk do gjejnë personin e përshtatshëm. Ne planin financiar duhet te ruani qetësinë dhe nuk duhet te veproni pa qene te bindur.

DEMI 21. prill - 21. maj

Marrëdhënia juaj ne çift nuk ka për te qene e mire sot. Nuk do jeni aspak tolerante me njeri-tjetrit dhe do konfliktoheni pafundësisht. Ne fakt nuk duhet t'ia hidhni gjithë fajin tjetrit sepse edhe vete keni gabimet tuaja. Beqaret duhet te marrin ne konsiderate çdo ftese qe do ju behet, por jo te nxitohen për te filluar lidhje. Për financat duhet te konsultoheni sa me pare me një specialist te fushës.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Stuhi te fuqishme pritet te fryjnë sot ne jetën tuaj ne çift. Mundohuni te ruani sa me gjate qetësinë dhe nga ana tjetër bëni përpjekje për ta ndryshuar situatën pa qene vone. Beqaret nga ana tjetër do kenë fat me shume se ditët e tjera dhe do realizojnë disa takime te këndshme. Financat do përmirësohen tej mase dhe kjo fale mbështetjes se madhe te familjareve dhe miqve.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Gjate kësaj dite do mbani përgjegjësi për te gjitha gabimet qe keni bere dhe do kërkoni falje pa ju dridhur zëri. Ne fund te fundit gjerat e gabuara duhen pranuar dhe situata duhet ndryshuar. Beqaret kane për t'i pasur gjerat me te lehta se me pare. Ata do kenë njohje interesante, por do preferojnë te presin për te hedhur hapat përfundimtare.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Gjate kësaj dite do dashuroheni me pasion me atë qe keni ne krah dhe atmosfera ne çift do jete përherë e ndezur. Asnjë moment nuk do ndiheni te mërzitur. Beqaret duhet te jene me te hapur dhe te dalin me këdo pavarësisht sesi mund t'iu duket ne përballjen e pare. Me paratë gjerat do ecin mire. Do dini si t'i menaxhoni ato dhe nuk do gjendeni aspak ne vështirësi.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Dite shume e kënaqshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Partneri do ju dashuroje pa dorashka dhe nuk do ngurroje as te përgatisë surpriza. Beqaret duhet t'i bëjnë sytë katër ne çdo moment pasi personi i ëndrrave mund te mbërrijë atëherë kur ata me pak do e presin. Ne planin financiar nuk do ju mungoje fati, prandaj nuk duhet te shqetësoheni.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Ndërmjet jush dhe partnerit çdo gjë do ece mire sot. Nuk do debatoni as për gjene me te vogël me te, përkundrazi toleranca dhe mirëkuptimi do mbizotërojë gjithë kohës. Beqaret nuk duhet te kërkojnë me ngulm fillimin e një lidhjeje sepse do bëjnë gabime. Buxheti do vazhdoje te mbetet i kënaqshëm sepse kohet e fundit keni ditur t'i menaxhoni me përkujdes te ardhurat.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dite e stuhishme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Te dy palët do kërkoni qe te dale e juaja dhe kjo mund te ndeze debate te forta. Beqaret ka rrezik te bëjnë edhe çmenduri vetëm qe ta ndryshojnë marrëdhënien e tyre. Buxheti do vazhdoje te mbetet i mire sepse do dini mire t'i bëni llogarite para se te shpenzoni. Vazhdoni ne këtë rruge.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Shtojini pak me shume dozat e imagjinatës gjate kësaj dite dhe keni për ta pare qe marrëdhënia me partnerin do behet me e qëndrueshme dhe me e bukur. Beqareve do filloje t'iu rrahe zemra shume fort për një person te cilin sapo e kane njohur. Financat ka rrezik te jene te paqëndrueshme dhe nuk do arrini dot te kryeni as shpenzimet me te nevojshme.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dite e bukur, me diell dhe ngjyra do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Pranë partnerit keni për te përjetuar emocione shume te forta. Beqaret sado qe te mundohen nuk do arrijnë dot ta gjejnë personin qe kane ëndërruar. Kjo e sotmja nuk do jete dita e tyre më me fat. Ne planin financiar situata ka për t'u përmirësuar tej mase.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Ka rrezik qe kjo e sotmja te jete një dite e ndërlikuar për ata qe janë ne një lidhje. Do keni here pas here debate me partnerin edhe për gjera elementare. Beqaret do kenë disa takime, po asnjeri me perspektive për te ardhmen. Buxheti nuk do jete i mire, megjithatë kjo nuk duhet t'iu dekurajoje aspak. Merrni masa sa me pare dhe keni për ta pare qe gjendja do ndryshoje shpejt.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Dite e bukur dhe e mbushur me emocione do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Do jeni te ty te përkujdesur ndaj njeri-tjetrit dhe do bëni te pamundurën qe te ndiheni sa me te lumtur. Beqaret do lodhen pak duke kërkuar dashurinë, por me pas jeta e tyre do ketë ndryshime rrënjësore. Ekuilibri financiar do mbizotërojë ne çdo moment, mos u shqetësoni.



HORIZONTAL: 1. Socialistët anglez. Tomas (shq.); 5. Mësi; 9. Populli i lashtë i Babilonisë; 12. Kalë me qenie të kaqëmirës si ai vendlë; 13. Gur i madh kalbë; 14. Kanal TV shesh Turk; 15. Njësi për matjen e gjatësisë; 16. Izabel Arbani; 17. Kënaqësi e ëmbël; 18. Mëllënjë; 19. I lodh njëri dikë, e kërpë; 20. Fjalëzim gjermanë, Lenor; 21. Pozicioni i vendit; 23. Shoe (fat.); 24. E ndarë e vogël e radionucleonit; 26. Krypësit i Zvicrës; 27. Ngjyrë.

VERTIKAL: 1. Sende si prodhuara për t'u shitur; 2. Kryesuesi shoe; 3. Cenonët frutor; 4. Ai (femër.); 5. Dëj mot; 6. Je drita; 7. Bumer i Australisë; 8. Pozitën mbrëv e qëllim; 9. Çfë ka si bëjë me hotelin; 10. Nënvizoheni së njëri shtylla me katër fuqi; 11. Hapë, gëlata (mësh.); 15. Numër shumëbujësh; 17. Kapë prej argjendi apo qelqi për si prit verë; 18. Ni asin lyrik; mustat; 19. Sumuk, lakër; 20. Dhanore e gjerë, vetëm "n"; 22. Tabelanë (shkurt); 23. Qytet në Kosë; 25. Antonio Banderas.

SOT U MBUSHEN NËNTË VITE NGA NDARJA JONË. I PËRJETSHËM MBETET KUJTIMI PËR TY.

Imer A. Imeri

(6 maj 1956 – 6 prill 2010)

Zemërplot e krenar që të patëm e përkujtojnë me mall këtë ditë e gjithë familja.

5 MILIONË TË VDEKUR NGA AJRI I NDOTUR

Ajri i ndotur po ul ndjeshëm jetëgjatësinë e njerëzve në të gjithë botën. Sipas një studimi të bërë nga Instituti Amerikan, ajri i ndotur në vitin 2017 shkaktoi mbi 5 milionë vdekje. Sipas studimit, ndotja për shkak të industrializimit, trafikut rrugor, apo përdorimit të druve dhe gazit për ngrohje e gatim, po rrit vdekshmërinë.

"Vendet më të prekura, kryesisht në Kinë dhe Indi, ku raportohen 1.2 milionë vdekje nga ndotja e ajrit çdo vit si edhe një sërë sëmundjesh të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare." Jetët e fëmijëve mund të shkurtohen me afro 30 muaj. Ajri i kontaminuar paraqet po aq rrezik për shëndetin e të rriturve. Studiuesit vlerësojnë se ka një lidhje të ndërsjellë mes nivelit të grimcave të rrezikshme dhe zhvillimit ekonomik të një vendi. Shtetet si SHBA-ja, Norvegjia, Kanadaja apo Suedia raportojnë cilësinë më të lartë të ajrit në botë ndërsa ato në zhvillim paraqiten më dobët.

Në studim është analizuar edhe Shqipëria, ku nënvizohet se janë shënuar hapa përpara për uljen e ndotjes së ajrit nga viti në vit, por numri i viktimave si pasojë e tij ka ardhur duke u shtuar. Shqipëria paraqitet më mirë se shumica e vendeve të tjera Ballkanit për sa i përket nivelit të ndotjes dhe numrit të viktimave të shkaktuara prej saj.

Shiten për 500.000 euro tri letra të Napoleonit për Jozefinën

Tri letra dashurie të shkruara nga Napoleon Bonaparti dhe bashkëshortja e tij, Jozefina mes viteve 1796 dhe 1804 u shitën për 513.500 euro dje në ankand në Paris, njoftoi shtëpia e shitjeve "Drouot". "Asnjë letër nga ti, e dashura ime e adhurueshme; duhet të jesh e zënë me gjëra shumë të ëmbla përderisa ke harruar bashkëshortin tënd që në mes të çështjeve dhe lodhjeve më eksesive vetëm të mendon dhe të dëshiron (...) Jam i izoluar. Ti më ke harruar. Kanë kaluar tetë ditë që qëndroj mbi kalë. Aspak net, aspak pushim, aspak gjumë", i shkruan gjenerali Bonapart më 18 prill 1796 Jozefinës, gjatë fushatës në Itali, sipas një ekstrakti nga një prej tre letrave të shitura.

Prezantohet taksi fluturues kinez pa pilot

Prodhuesi kinez EHang dje në Vjenë për herë të parë i paraqiti publikut një dron-taksi, një fluturake pa pilot që do të mbajë dy pasagjerë në lartësi të ulëta në distancë deri në 35 kilometra.

Teknologjia tani është e gatshme për prodhimin industrial, por qeveria është ende duke pritur për këtë avion, tha drejtori i marketingut i kompanisë kineze Derik Siong. "Sfida jonë kryesore nuk është më teknologjia, por rregulloret dhe nëse publiku është i gatshëm të përdorë pajisje të tilla", tha ai në një prezantim për mediat në kryeqytetin austriak, raporton AP.

Gazetarët dhe fotografët u ftuan për një fluturim të shkurtër testues - një ngjitje vertikale prej dhjetë metrash, pasuar nga aterrimi në stadiumin e futbollit.

Synet në shtëpi, humb jetën një tjetër fëmijë

Në vetëm pak muaj, 3 fëmijë kanë humbur jetën në Italinë fqinje si pasojë e rrethprerjes në shtëpi, apo të kryer jo nga mjekë profesionistë. Një tjetër rast u publikua në media, viktimë e së cilit mbeti një bebe pak javëshe. Shkak u bë rrethprerja e kryer në shtëpi, nga një "njeri i shenjtë". Ngjarja e rëndë ndodhi në Quezzi, pranë Genovas.

Për ngjarjen autoritetet policore arrestuan nënën dhe gjyshen e djalit, së bashku me personin që kreu procedurën. Nuk ka shumë detaje rreth ngjarjes, megjithatë besohet se prindërit e të miturit janë nigerianë. Ngjarja e rëndë vjen pasi një fëmijë 5 muajsh vdiq në Mars në Bolonja, në Itali, pasi prindërit e tij dyshohet se e bënë synet në shtëpi. Në

Dhjetor, një djalë 2 vjeç gjeti vdekjen për shkak të gjakderdhjes, si pasojë e rrethprerjes në një qendër emigrantësh në Romë.

Jeta e vëllait të tij binjak u vu gjithashtu në rrezik, por ai mbijetoi pasi u mbajt në kujdes intensiv. Rreth 35 përqind e rrethprerjeve në Itali besohet se kryhen në shtëpi. Shkak është kryesisht çmimi i lartë i kësaj procedure. Në të tre rastet e mësipërme, prindërit e fëmijëve ishin refugjatë.

KALENDARI HISTORIK 6 PRILL

402 - Beteja e Pollentias: Ushtria romake nën udhëheqjen e Stiliçios mund Visigotët.

1106 - Zjarr i madh kaplon Venedikun.

1320 - Skocezët rikonfirmojnë pavarësinë e tyre duke nënshkruar Deklaratën e Arbrothit.

1664 - Franca dhe saksonët nënshkruajnë aleancë.

1667 - Tërmeti shkatërron Dubrovnikun, atëherë qytet-shtet i pavarur.

1672 - Franca i shpall luftë Holandës.

1830 - Joseph Smith dhe pesë persona të tjerë organizojnë ndërtimin e Kishës së Mormonëve në Seneka, Nju Jork.

1848 - Hebrenjve të Prusisë u jepet barazia.

1889 - George Eastman nxjerr në shitje për herë të parë Kamerën Kodak.

1917 - SHBA i shpall luftë Gjermanisë, futet në Luftën e Parë Botërore.

1939 - Britania e Madhe dhe Polonia nënshkruajnë pakt ushtarak.

1964 - Egjipti dhe Belgjika rregullojnë marrëdhëniet diplomatike.

1981 - Qeveria e Jugosllavisë dërgon forca policore në Kosovë.

1992 - Trupat serbe fillojnë rrethimin e Sarajevës.

A E DINI SE...

BRETKOSAT DREJT ZHDUKJES

90 specie amfibësh janë zhdukur dhe 500 të tjera janë në reduktim të dukshëm brenda 50 viteve të fundit. Ky është bilanci dramatik, si pasojë e përhapjes së një myku, i cili ka origjinën në Azi dhe po transportohet në të gjithë botën. Sipas kreut të studimit të Universitetit Kombëtar Australian njerëzit janë duke spostuar bimë e kafshë në të gjithë globin me një ritëm gjithnjë e më të shpejtë, duke përhapur kështu edhe agjentë patogjenë jashtë habitatit të tyre. Por kjo ka sjellë pasoja të rënda për ekosistemin. Në rastin konkret, sipas studimit që është publikuar në revistën Science, zhdukja e 90 llojeve bretkosash është humbja më e madhe në biodiversitet e regjistruar ndonjëherë nga biologjia. Myku në fjalë i quajtur "Batrachochytrium" ndikon negativisht në organizmin e amfibëve. Ai prek keratinën e lëkurës, të cilën e degradon dhe shkatërron duke i shkaktuar ngordhjen e kafshës.

THËNIA E DITËS

Çdo gjë në natyrë është e mrekullueshme dhe çdo mrekulli është e natyrshme!
(Imam Gazaliu)